

SEED – ETF

**STUDIM MBI NDIKIMIN E NDËRMARRJEVE
TË VOGLA DHE TË MESME NË RRITJEN EKONOMIKE TË
SHQIPËRISË: 1997 – 2002**

Përgatitur nga QKZh Tirane dhe Z. Franz-Josef Klein

Tiranë, Dhjetor 2002

Mbi Raportin	5
Falenderime	6
Rreth Autorëve	7
Shkurtime	8
Përfundimet Kryesore	9
Përmbledhje	11
 Kapitulli I	
<i>PËRKUFIZIMET DHE METODOLOGJIA</i>	15
1. Përkufizimi i indikatorëve	15
1.1. Indikatorët Statistikorë	15
1.2. Indikatorët e Vrojtimeve të Biznesit	17
2. Identifikimi i madhësisë së ndërmarrjeve	18
 Kapitulli 2	
<i>VLERËSIMI I ZHVILLIMIT TË NVM-VE, 1997-2000</i>	20
1. Vrojtim i përgjithshëm për rëndësinë e NVM	20
2. Krahasimi me NVM europiane	21
3. Ndikimi i privatizimit	23
4. Ndikimi i madhësisë së ndërmarrjeve në rritjen ekonomike	24
4.1 Shifra e afarizmit	24
4.2 Vlera e shtuar	26
4.3 Numri i punonjësve	27
4.4 Numri i ndërmarrjeve	28
4.5 Rritja e investimeve	30
4.6 Prodhimtaria	31
4.7 Përfitimi i ndërmarrjeve	33
 Kapitulli 3	
<i>VLERËSIMI I ZHVILLIMEVE TË FUNDIT TË NVM DUKE PËRDORUR REZULTATET E VB . .</i>	34
1. Parathënie për vrojtimit e biznesit	34
2. Zhvillimet e fundit në sektorin e industrisë	34
2.1. Indikator i besueshmërisë për industrinë	34
2.1.1. Kërkesat për eksport dhe parashikimet e eksportit	37
2.1.2. Parashikimet e punësimit	38
2.2. Kufizimet e prodhimit	39

3. Zhvillimet e fundit në sektorin e ndërtimit	40
3.1. Indikatori i besueshmërisë në ndërtim	40
3.2. Faktorët që kufizojnë aktivitetin e ndërtimit	43
4. Investimet	44
4.1. Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve	44
4.2. Faktorët që kufizojnë investimet në të ardhmen	45

Kapitulli 4

<i>PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME TË PROJEKTIT</i>	47
---	----

Aneks

Aneks 1. Studime të mëparëshme mbi zhvillimin e NVM	49
Aneks 2. Indikatorët e NVM sipas sektorëve	51
Aneks 3. Fillimi i veprimtarisë së NVM sipas teritorit	53

Lista e Tabelave

Tabela 1: Rëndësia ekonomike e NVM, 2000	20
Tabela 2: Indikatorët kryesorë bazuar tek numri total i ndërmarrjeve në Europë-19 dhe Shqipëri, 2000	22
Tabela 3: Struktura e të gjitha Vëndeve Kandidate, Shqipëria dhe Europë -19, 1999	22
Tabela 4: Madhësia mesatare e ndërmarrjeve, Vëndet Kandidate, Shqipëria, dhe Europë-19, 1998-2000	22
Tabela 5: Prodhimtaria sipas madhësisë ndërmarrjeve, 1997-2000	31

Lista e Figurave

Figura.1: Shifra e afarizmit si % e totalit (1997-2000)	21
Figura.2: Përfitimi, ndryshimet vjetore (1997-2000)	21
Figura.3: Vlerësimi i prodhimit, aktiviteti industrise sipas madhësisë (1997-2000)	21
Figura.4: Punësimi në ndërmarrjet private dhe publike, 2002	23
Figura.5: Shifra e afarizmit sipas madhësisë ndërmarrjeve në % të totalit (1997-2000)	24
Figura.6: Shifra e afarizmit për mikondërmarrjet në % të totalit (1997-2000)	24
Figura.7: Shifra e afarizmit sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	25
Figura.8: Shifra e afarizmit për mikrondërmarrjet, ndryshimet vjetore (1997-2000)	25
Figura.9: Vlera e shtuar sipas madhësisë ndërmarrjeve në % të totalit (1997-2000)	26
Figura.10: Vlera e shtuar sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	26
Figura.11: Vlera e shtuar për mikrondërmarrjet, ndryshimet vjetore (1997-2000)	26
Figura.12: Numri punonjësve sipas madhësisë ndërmarrjeve në % të totalit (1997-2000)	27
Figura.13: Numri i punonjësve sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	27
Figura.14: Numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë në % të totalit (1997-2000).....	28
Figura.15: Numri i ndërmarrjeve për mikrondërmarrjet, ndryshimet vjetore (1997-2000)	28
Figura.16: Numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë, ndryshimet vjetore (1997-2000)	29

Figura.17: Investimet sipas madhësisë ndërmarrjeve në % të totalit (1997-2000)	30
Figura.18: Investimet sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	30
Figura.19: Vlera e shtuar për punonjës sipas madhësisë së ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	31
Figura.20: Vlera e shtuar për punonjës në mikrondërmarrjet, ndryshimet vjetore (1997-2000)	32
Figura.21: Pjesa e kostos punës ndaj vlerës shtuar sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	32
Figura.22: Përfitimi sipas madhësisë ndërmarrjeve në % të totalit (1997-2000)	33
Figura.23: Përfitimi sipas madhësisë ndërmarrjeve, ndryshimet vjetore (1997-2000)	33
Figura.24: Indikatori besueshmërisë së industrisë 2002	35
Figura.25: Indikatori besueshmërisë së industrisë NVM-80	35
Figura.26: Përbërësit e indikatorit besueshmërisë së industrisë 2002	35
Figura.27: Indikatori besueshmërisë së industrisë, ndërmarrjet e vogla, 2002	35
Figura.28: Indikatori besueshmërisë së industrisë, ndërmarrjet e mesme, 2002	36
Figura.29: Indikatori besueshmërisë së industrisë, ndërmarrjet e mëdha, 2002	36
Figura.30: Kontaktimet e eksportit në industri, sipas madhësisë ndërmarrjeve, 2002..	37
Figura.31: Kontraktimet e eksportit në industri, për NVM-80	37
Figura.32: Parashikimet e eksportit në industri, sipas madhësisë ndërmarrjeve, 2002	37
Figura.33: Parashikimet e eksportit në industri për NVM-80	37
Figura.34: Parashikimet e punësimit në industri sipas madhësisë ndërmarrjeve, 2002	38
Figura.35: Parashikimet e punësimit në industri, për NVM-80	38
Figura.36: Kufizimet për prodhimin në industri sipas madhësisë ndërmarrjeve, janar 2002	39
Figura.37: Kufizimet për prodhimin në industri sipas madhësisë ndërmarrjeve, tetor 2002	39
Figura.38: Indikatori besueshmërisë në ndërtim, 2002	41
Figura.39: Indikatori besueshmërisë në ndërtim për NVM-80	41
Figura.40: Përbërësit e indikatorit besueshmërisë në ndërtim, 2002	41
Figura.41: Indikatori besueshmërisë në ndërtim për ndërmarrjet e vogla, 2002	41
Figura.42: Indikatori besueshmërisë në ndërtim për ndërmarrje e mesme, 2002	41
Figura.43: Indikatori besueshmërisë në ndërtim për ndërmarrjet e mëdha, 2002	41
Figura.44: Kufizimet për prodhimin në ndërtim sipas madhësisë ndërmarrjeve, prill 2002	43
Figura.45: Kufizimet për prodhimin në ndërtim sipas madhësisë ndërmarrjeve, shtator 2002	43
Figura.46: Investimet në industri sipas madhësisë ndërmarrjeve, prill 2002	44
Figura.47: Investimet në industri sipas madhësisë ndërmarrjeve, tetor 2002	44
Figura.48: Faktorët kryesorë të industrisë që kufizojnë investimet e planifikuara, sipas madhësisë ndërmarrjeve, prill 2002	45
Figura.49: Faktorët kryesorë të industrisë që kufizojnë investimet e planifikuara, sipas madhësisë ndërmarrjeve, tetor 2002	45

Mbi Raportin

Ky raport u përgatit me kërkesën e SEED dhe ETF sipas Termave të Referencës për projektin “Studim mbi ndikimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në rritjen ekonomike të Shqipërisë”. Konceptimi i studimit u bë me synim që të vlerësohet ndikimi dhe roli i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në rritjen ekonomike, duke përdorur për herë të parë një grup indikatorësh kuadër, të cilët janë zgjedhur për të qënë në përputhje me standardet e BE.

Me këtë raport te ri, SEED u jep institucioneve publike, organizatave të biznesit dhe studiuesve të pa varur një vlerësim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, lidhur me zhvillimin dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike, për periudhën 1997-2002. Ai siguron, nëpërmjet një numri treguesish, një informacion të ditëve të fundit dhe lehtësisht të lexueshëm lidhur me zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike, nëpërmjet një numri indikatorësh.

Rezultatet janë bazuar në indikatore të ndryshëm, të paraqitur sipas madhësisë së ndërmarrjes, për periudhën 1997-2000 dhe 2002. Të dhënat janë siguruar nga Instituti i Statistikave dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Tiranë.

Raporti përmban kapitujt e më poshtëm:

Kapitulli I, “Përkufizimet dhe Metodologjia”, trajton përkufizimet e indikatorëve statistikorë dhe atyre të përdorur në vrojtimit e biznesit, dhe siguron rëndësinë dhe metodologjinë e vlerësimit të të dhënave.

Kapitulli II, “Vlerësimi i zhvillimit të NVM-ve, 1997-2000”, në të cilin sigurohet një informacion i hollësishëm lidhur me zhvillimet e NVM në perjudhën ndërmjet 1997 dhe 2000, duke përfshirë ndryshimet në pronësinë private dhe ndikimin e privatizimit. Analiza përdor të dhënat statistikoore, bazuar në indikatorët e përshkruar në Kapitullin I.

Kapitulli III, “Vlerësimi i zhvillimeve të fundit të NVM duke përdorur rezultatet e VB”, siguron informacion lidhur me tendencat e zhvillimit të NVM në sektorët e industrisë dhe ndëritmit, dhe më tej e plotësuar me faktorët që pengojnë aktivitetin e biznesit gjatë 2002.

Kapitulli IV shtron një numër rekomandimesh për politaikat dhe sygjeron për të ardhmen veprimet që duhen vazhduar

Falenderime

Ky projekt është një përpjekje e përbashkët e mjaft specialistëve. Veçanërisht ai është kontribut i autorëve, Z. Franz-Josef Klein për idetë e tij të çmuara në hartimin në tërësi të projektit dhe personelit të QKZh-së që u angazhua në këtë projekt, Mirlinda Gajo-Rusi, Albert Gajo, Rozi Poga, Genc Çelo dhe Lindita Sadiraj.

Autorët e drejtojnë mirënjohjen e tyre dhe falenderojnë personelin e SEED-it, Hans Schrade, Anila Bashllari dhe Silvana Rusi, për angazhimin e tyre profesional dhe përkushtimin për të mbështetur autorët në të gjitha fazat e projektit.

Dëshërojmë të shprehim konsideratë të veçantë për personat e tjerë që dhanë komente të vlefshme për materialin fillestar të këtij raporti, Bashim Sykja dhe Fatbardh Çangu të Ministrisë së Ekonomisë, Lida Kita e ETF, po ashtu për Milva Ekonomi, drejtore e INSTAT, e cila mundësoi dhënien e informacionit të vlefshëm statistikor.

SEED dhe ETF mirëpresin komentet për përmbajtjen e këtij dokumenti, si dhe sygjerimet për përmirësimin e këtij raporti. Rezultatet dhe informacioni i këtij raporti mund të përdoret me kushtin e citimit të plotë të burimit të informacionit.

Rreth Autorëve

QKZh Tirana është një organizatë e pavarur jo-fitim prurëse, e regjistruar në Gjykatën e Tiranës me 27.03.2001. QKZh krijon dhe shpërndan njohuri lidhur me zhvillimet ekonomike dhe mbarëvajtjen e biznesit, me synim për të ndihmuar institucionet publike dhe komunitetin e biznesit që të hartojnë politika të përshtatëshme për një shoqëri më të mirë. QKZh-ja kryen anketime të biznesit dhe konsumatorëve, organizon mbledhje dhe publikon rezultatet e kërkimeve lidhur me zhvillimet e fundit të biznesit dhe faktorët që pengojnë prodhimin dhe investimet në të ardhmen.

Franz-Josef Klein punoi si konsulent, pas një përvoje shumë të gjatë në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare në Komisionin Europian, në Bruksel. Detyrë e tij parësore ka qenë përgatitja dhe zbatimi i Programit të Harmonizuar të Bashkimit Europian, për anketimet e biznesit dhe konsumatorëve në shtetet anëtare të Europës së Bashkuar dhe vëndet që kanë aplikuar. Z. Klein është veçanërisht i specializuar për analizat e ciklit të biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve private.

Shkurtime

BE	Bashkimi European
EQL	Europa Qëndrore dhe Lindore
ETF	Fondacioni European për Trainim (<i>European Training Foundation</i>)
INSTAT	Instituti Statistikave
Mikro	Mikrondërmarrje, me 1 deri 4 punonjës
NMd	Ndërmarrjet e Mëdha, me mbi 50 punonjës
NMs	Ndërmarrjet e Mesme, me 20 deri 49 punonjës
NV	Ndërmarrjet e Vogla, me 1 deri 19 punonjës
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme deri me 50 punonjës
NVM-80	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme deri me 80 punonjës
OJP	Organizata Jofitm Prurëse
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PBK	Prodhimi Bruto Kombëtar
QKZh	Qendra për Kërkim dhe Zhvillim
SEED	Zhvillimi i Ndërmarrjeve në Europën Juglindore (<i>Southeast European Enterprise Development</i>)
Sh.Af	Shifra e Afarizmit
ToR	Termet e Referencës (<i>Terms of Reference</i>)
TOTAL	Vlera e indikatorëve për numrin total të ndërmarrjeve
V.Sh	Vlera e Shtuar
VB	Vrojtimi i Biznesit

Rëndësia e NVM

Arësytet kryesore të studimit të ndikimit të NVM në rritjen ekonomike janë të lidhura me faktorët që vijnë:

- NVM përbëjnë rreth 99 % të numrit të ndërmarrjeve;
- Shifra e afarizmit të NVM përbën rreth 71 % të totalit;
- NVM sigurojnë shumicën e punësimit;
- NVM janë ndërmarrjet më dinamike.

Veçoritë e NVM

Pothuajse 91.1 % e ndërmarrjeve punësojnë më pak se 4 vetë.

Për këtë arsye mund të thuhet se struktura e ndërmarrjeve në Shqipëri bazohet në mikro ndërmarrjet. Kjo shifër varion mesatarisht nga 1.9 për ndërmarrjet e vogla në 31.4 për ndërmarrjet e mesme.

NMs janë ndërmarrjet më dinamike dhe kanë ndikuar më shumë në rritjen ekonomike gjatë periudhës 1997-2000.

Kjo vërtetohet nga shumica e indikatorëve, si Sh.Af, V.Sh, punësimi dhe numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë, gjë që konfirmon të njëjtin konkluzion. Për sa i përket numrit të të punësuarëve, NMs janë struktura më e preferuar për një ndërmarrje. Analiza e Sh.Af, sipas madhësisë së ndërmarrjeve, tregon që gjatë periudhës 1997-2000 indikator i madhësisë së ndërmarrjeve ishte në lidhje pozitive me rritjen ekonomike vetëm për ndërmarrjet e mesme, të cilat punësojnë 20 deri 50 punonjës, dhe ishte në lidhje negative tek mikro ndërmarrjet.

Ritmet e rritjes për NV janë gjithmonë në ulje dhe bëhen negative gjatë periudhës në studim.

Në vitin 2000, rritja e NV është negative me 1 %, e cila mund të ketë ardhur si pasojë e ndryshimeve në legjislacionin fiskal, të bëra në vitin 2000. Në 2002, rezultatet e VB tregojnë se rritja e NVM në sektorin e industrisë dhe ndërtimit është afërsisht negative.

Investimet e NVM gjatë viteve 1997-2000 tregojnë disa luhajtje.

Investimet e kryera nga NVM në vitin 1999 i tejkalojnë ato të NMD, dhe në vitin 2000 investimi total zvogëlohet me rreth 25 %. Vetëm ndërmarrjet e mesme në vitin 2000 kanë patur mundësi të rritin nivelin e investimeve, krahasuar me nivelin e vitit 1999. Është e rëndësishme të theksohet fakti se zvogëlimi i investimeve në dy grupet e tjera është mjaft i lartë, respektivisht 25 % për NMD dhe 21 % për NV. Në tetor të vitit 2002 shumica e NVM në sektorin e industrisë kanë filluar të investojnë për zëvendësimin e paisjeve të vjetra dhe gjithashtu për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese (kjo kryesisht për NMs). Në këtë fazë zhvillimi, NVM janë më pak të interesuara për të investuar në futjen e teknikave të reja të prodhimit, kursimit të energjisë, ruajtjes së mjedisit, etj.

Prodhimtaria për punonjës ka korrelacion me treguesin e kostos së fuqisë punëtore.

Rezultatet e VB pohojnë që informacioni statistikor për perjudhën 1997-2000 ka treguar që NMs luajnë një rol të rëndësishëm për rritjen potenciale të punësimit, por këto mundësi, në të njëjtën kohë janë të kufizuara për NV.

Mikro ndërmarrjet janë struktura më eficiente nga pikëpamja e rezultatit financiar.

Ky rezultat është pak i vecantë nëse marrim parasysh faktin që madhësia e ndërmarrjes dhe eficienta janë zakonisht në proporcion të zhdrejtë.

Kufizimet e biznesit

Pronarët e NVM, shumë shpesh, identifikojnë faktorët e mjedisit të biznesit si faktorët që pengojnë zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Mungesa dhe ndërprerjet e furnizimit me energji është faktori më i rëndësishëm që pengon aktivitetin e NVM. Faktori i dytë që pengon NVM është legjislacioni fiskal i paqartë dhe zbatimi jo korrekt i tij. Në tetor 2002, drejtuesit e NVM kanë konsideruar mungesat në infrastrukturë si një faktor të rëndësishëm që pengon zhvillimin e biznesit të tyre.

Faktori i kërkesës konsumatore, është gjithashtu një faktor pengues për NVM në Shqipëri.

Në tetor 2002 mungesa e kërkesës nga konsumatorët vëndas është një faktor i rëndësishëm kufizues për NVM, i cili bën që në tetor 2002 ndikimi në NMs të jetë po në të njëjtën shkallë si dhe në NVM (i renditur si faktor i katërt në tetor).

Përsa i përket furnizimit me materiale, duhet theksuar se vetëm konkurrenca nga importi identifikohet si një faktor kufizues për zhvillimin e biznesit të NVM.

Në ndërtim, pengesat më kryesore për NVM janë faktorët e **zbatimit të pandershëm të legjislacionit fiskal dhe atij të prokurimeve.** Vështirësitë për të marrë kredi dhe problemet e likuiditeteve financiare janë gjithashtu të rëndësishme për zhvillimin e NVM, në sektorin e ndërtimit.

Frika nga një fitim i pamjaftueshëm është faktori më i rëndësishëm që kufizon NVM lidhur me planifikimin e investimeve për 2002.

Përderisa, fitimi është i vetmi mjet për investimet në sektorin e NVM, rezultatet e tilla tregojnë që gjatë 2002 përfitimi i NVM është drejt paksimit.

Përmbledhje

Ky raport është tentativa e parë për të paraqitur një tablo të cilësive në zhvillimin e NVM dhe ndikimit të tyre në rritjen ekonomike në Shqipërisë. Studimet e mëparshme (shiko Aneksin 1) kanë qenë kryesisht të fokusuar me nevojat për mbështetjen e NVM, të kuadrit rregullues të tyre dhe studimeve që lidhen me ndikimin e aktivitetit informal në zhvillimin e NVM.

Në këtë studim, analiza e zhvillimit të NVM gjatë pesë viteve të fundit, bazohet në një grup indikatorësh kryesorë, të cilët janë llogaritur në përputhje me sistemet e pranuar ndërkombëtare. Një veçanti tjetër e rëndësishme e këtij Raporti është kryerja e analizës së zhvillimit të NVM për vitin 2002, duke përdorur për herë të parë të dhënat e Vrojtimeve të Biznesit.

Ky Raport përmban:

- I. Analizën e NVM, që bazohet në dy grupime të indikatorëve bazë: indikatorët sasiorë dhe ata cilësorë. Ata janë përdorur për të vëzhguar mbarëvajtjen e NVM dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike. Indikatorët sasiorë, ose statistikorë janë përdorur për të vërejtur ndryshimet në vite të strukturës së NVM, si dhe për të vlerësuar ndikimin e tyre në rritjen ekonomike gjatë periudhës 1997-2000 (të dhënat statistikore për vitet 2001 dhe 2002 nuk disponohen). Indikatorët janë vlerësuar për secilën klasë madhësie të ndërmarrjeve dhe ata janë analizuar sipas renditjes së mëposhtme:

1. Shifra e afarizmit – struktura dhe ndryshimet vjetore
2. Vlera e shtuar – struktura dhe ndryshimet vjetore
3. Numri i punonjësve – struktura dhe ndryshimet vjetore
4. Numri i ndërmarrjeve – struktura dhe ndryshimet vjetore
5. Investimet – struktura dhe ndryshimet vjetore
6. Prodhimtaria (*labour productivity*)– struktura dhe ndryshimet vjetore
7. Pjesa e kostos së punës në vlerën e shtuar – ndryshimet vjetore
8. Përfitimi (*profitability*) i ndërmarrjeve – ndryshimet vjetore

Grupi i dytë i indikatorëve përdoret për të çmuar klimën e biznesit të NVM-ve, tendencat e zhvillimeve afatshkurtra, si dhe faktorët që pengojnë aktivitetin e tyre. Këta indikatorë janë:

9. Vlerësimi i aktivitetit industrial – si një indikator i përbërë
10. Parashikimi i punësimit – si balancë
11. Parashikimi i çmimeve – si balancë
12. Parashikimi i eksporteve – si balancë
13. Parashikimi kërkesave për eksport – si balancë
14. Shfrytëzimi i kapaciteteve – si përqindje
15. Investimet kapitale – si drejtim
16. Kufizimet për prodhimin – si dendësi

- II. Studimi mundëson (por jo kurdoherë është e mundur), që nëpërmjet ndryshimeve të zhvillimeve për secilin indikator, të tregojë ndikimin e faktorëve më të rëndësishme që mund të kenë influencuar në zhvillimin e NVM. Të tillë faktorë janë p.sh. politikat qeverisëse që reflektohen në legjislacionin fiskal, privatizimi etj. Treguesit statistikor paraqiten për tërësinë e ndërmarrjeve (sipas madhësisë) dhe në Aneksin 2 jepen të njëjtët indikatorë statistikorë, sipas degëve kryesore të ekonomisë: industri, ndërtim, tregti, komunikacion dhe shërbime të

tjera. Për derisa informacioni statistikor që sigurohet nga INSTAT nuk është pjesë e Sistemit Llogarive Kombëtare (i cili ende nuk është ngritur), analizat e ndikimit të NVM në rritjen ekonomike, mund të vërehen në një perspektivë të afërt për ndikimin e përgjithshëm në ekonominë shqiptare. Megjithatë, kur ka qenë e mundur, raporti përmban vlerësime të përgjithëshme për tendencat e zhvillimit të NVM, mbarëvajtjes së tyre dhe ndikimin në ekonominë shqiptare.

Përdorimi i indikatorëve të ndryshëm, bën të mundur që të shikohen ndryshimet për secilin grup ndërmarrjesh, duke ndjekur zhvillimet më të rëndësishme të NVM gjatë periudhës së studimit. Rezultatet e analizës për secilin indikator paraqiten si më poshtë:

1. **Indikatori i shifrës së afarizmit** tregon se gjatë periudhës 1997-2000 më shumë se gjysma e volumit të afarizmit ka qënë rezultat i veprimtarisë së NV dhe 2/3 e saj janë realizuar nga mikro ndërmarrjet. NMs, gjatë periudhës 1997-2000, konsiderohen si grupimi më i pëlqyshëm i ndërmarrjeve. Kjo për faktin se indikator i Sh.Af tregon një rritje të vazhdueshme për NMs. Gjatë kësaj perjudhe, NV humbën disi rëndësinë e tyre duke kontribuar më pak në rritjen ekonomike.
2. **Indikatori i V.Sh** tregon që kontributi i NMs është dyfishuar në periudhën 1997-2000, ndërsa pjesa e kontributit të NV mbetet pothuajse i pandryshuar. NMs kanë rritmin e rritjes më të lartë se rritja mesatare e totalit. Korelacioni i vlerës së shtuar me madhësinë e ndërmarrjes është më i qëndrueshëm për NMs.
3. **Numri i punonjësve** ka ardhur duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht gjatë periudhës 1999-2000. NV dhe NMs kane ndikuar negativisht në rritjen e punësimit TOTAL. Në 2000, punësimi total ka qënë 143985 vetë, në të cilët 77146 vetë janë punësuar nga NVM.
4. **Indikatori i numrit të ndërmarrjeve** tregon që gjatë periudhës 1997-2000 rritmi i rritjes vazhdimisht zvoglohet për NV dhe NMD. Ndërkohë që numri i NMs rritet gjatë këtyre viteve.
5. **Indikatori i investimeve** tregon se NMD kanë kryer shumicën e investimeve gjatë periudhës 1997-1998, sepse pas krizës së vitit 1997 duket se ky grupim ka qënë më i aftë të ndërmerre programe të tilla investimi. Në vitet pasardhëse, investimet e NMD kanë një rënie të vazhduar. NMs kanë investuar vazhdimisht dhe pjesa e tyre ka ardhur duke u rritur në vite.
6. **Indikatori i prodhimit (labour productivity)** tregon që NMs kanë arritur një efikasitet ekonomik më të mirë. NV, përfshi dhe Mikro kanë qënë gjithashtu të afta që të rregullojnë nivelet e prodhimit dhe koston e produktit.
7. **Pjesa e koston së punës në V.Sh**, në 2000, ka qënë respektivisht për NV 21.1 %, NMs 19.2 % dhe për NMD 38.4 %.
8. **Indikatori i Përfitimit të ndërmarrjes** në 2000 tregon që mikro ndërmarrjet, në krahasim me grupet e tjera të ndërmarrjeve, janë më fitimprurëset. Ky rezultat është i pak i veçantë, sepse në përgjithësi madhësia e ndërmarrjes është në korelacion pozitiv me përfitimin. NMs janë afër përfitimit mesatar të NVM. Në 1999, NMD kanë rritur përfitimin kundrejt asaj të NVM, por në 2000 ato mbeten ende prapa nivelit të përfitimit të NVM.

9. Gjatë 2000, **indikator i besueshmërisë së aktivitetit** në sektorin industrial për NV është negativ. Në maj 2002, ky indikator ulet me një pikë, që do të thotë se drejtuesit janë më pesimistë se në janar 2002. Në tetor 2002, indikator i besueshmërisë të aktivitetit tregon që drejtuesit e NV janë më pak të shqetësuar me 7 pikë, se sa në maj 2002. Indikator i besueshmërisë së aktivitetit për NMs, tregon që klima e biznesit për këtë klasë madhësie ka ardhur duke u keqsuar. Në tetor 2002, drejtuesit e NMs u bënë optimistë për zhvillimin e biznesit të tyre (treguar me shenjë pozitive 4 %, në indikatorin e vlerësimit të aktivitetit).
 10. Indikatorët e **kërkesave për eksport dhe parashikimeve për eksport** kanë një rëndësi të veçantë në situatën kur nuk ka të dhëna statistikore për eksportet. Indikator i nxjerr në pah tendencën për eksport. Drejtuesit e NVM janë pesimistë për eksporte gjatë vitit 2002. Situata duket disi më e mirë në tetor 2002. NMs dhe NMD presin rritje në 2003.
 11. Indikator i **parshikimit të punësimit** është në korelacion pozitiv me prodhimin. Vlerësimi për NMs dhe NMD tregon që punësimi në këto klasa madhësie pritet të rritet gjatë 2003. NV pritet të tkuren në vitin 2003.
 12. Indikator i **kufizimeve të prodhimit** nxjerr në pah ndryshimin e mjedisit të biznesit në kohë.
 - Mungesa e energjisë elektrike është kufizuesi më i madh për biznesin (në janar dhe tetor 2002 ka po të njejtën peshë në të gjitha klasat e madhësisë së ndërmarrjeve).
 - Legjislacion fiskal i paqartë (keq-interpretimi/keq-zbatimi) renditet i dyti sipas kufizimeve në janar 2002, por në tetor ai renditet i pesti. NMs në janar 2002 pengohen më pak se klasat e tjera të madhësisë, por ky pengim është më i madh në tetor 2002.
 - Mungesa e kërkesave të brendshme është një kufizim tjetër i rëndësishëm për NVM dhe NMs, në janar 2002. Në tetor ky kufizim renditet i katerti, por është më pak i rëndësishëm për NMs.
 - Mungesa e infrastrukturës renditet e treta si kufizim në janar 2002, por në tetor ajo renditet e dyta. NMs e konsiderojnë këtë kufizim më të rëndësishëm se sa klasat e tjera të madhësisë.
 - Problemet financiare konsiderohen kufizim i rëndësishëm për NVM në tetor 2002.
 13. **Indikator i besueshmërisë të aktivitetit të ndërtimit** vlerësohet sipas dy faktorëve: (1) kontratave të lidhura dhe (2) parashikimet e punësimit. Në shtator 2002 vërehet një pikë kthese pozitive për këtë indikator dhe kjo si ndikim i NMD.
- III. Për ndjekjen dhe monitorizimin më të plotë të NVM, rekomandohen përmirësime të sistemit statistikor shqiptar, si dhe vazhdimësia e zhvillimit të anketimeve të biznesit, si një instrument për të gjeneruar informacione komplementare lidhur me NVM, gjatë periudhës kur informacioni statistikor nuk është i mundshëm. Në këtë kuadër rekomandimet që kanë të bëjnë me informacionin në lidhje me NVM përmbledhen si më poshtë:
1. INSTAT duhet të shpejtojë procesin e zbatimit të Sistemit të Llogarive Kombëtare bazuar në praktikat e njohura ndërkombëtare.
 2. INSTAT duhet të rishikojë paraqitjen e informacionit statistikor në lidhje me biznesin, që të jetë në përputhje me klasifikimin e dhënë për ndërmarrjet në Ligjin Nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”.

3. Të dhënat statistikore nga anketimet e biznesit (të kryera nga INSTAT) duhet të jenë të disponueshme të paktën çdo tre muaj.
4. Vazhdimi i punës për të kryer vrojtime periodike cilësore të biznesit, (të cilat duhet te kryhen në përputhje me programin e harmonizuar të BE për vrotimin e biznesit).
5. Organizimi i një anketimi të veçantë vjetor të vëzhgimit të NVM. Ky vëzhgim do të lidhet direkt me sipërmarrjen dhe administrimin, përgjegjësitë administrative dhe taksimin si dhe probleme të tjerra, të cilat janë të veçanta për mjedisin e veprimtarisë së NVM dhe që përgjithësisht mungojnë nga ky raport.

PËRKUFIZIMET DHE METODOLOGJIA

1. Përkufizimi i indikatorëve

Ky studim është bazuar në një grup indikatorësh të kërkuar në ToR, si dhe në disa indikatorë të tjerë, të cilët janë përzgjedhur nga autorët për të vlerësuar më mirë rritjen e ndërmarrjeve dhe ecurinë e tyre sipas madhësisë. Këta indikatorë janë në përputhje dhe përdoren nga Komisioni Europian për të vlerësuar NVM në BE, si dhe të vëndeve kandidate për në BE¹. Indikatorët e përzgjedhur ndahen në dy grupe, indikatorë sasiorë dhe cilësorë. Grupi i parë i indikatorëve njihen si indikatorë statistikorë dhe të dytët si indikatorë të tendencave, vlerësimi i të cilëve bazohet në të dhënat cilësore të mbledhura në mënyre të veçantë nëpërmjet VB.

Përgatitja e këtij raporti është bazuar në të dhënat e siguruara nga INSTAT dhe QKZh Tiranë. Të dhënat lidhur me zhvillimet e eksportit, të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk janë përdorur në këtë raport, sepse nuk ishte e mundur që të paraqiteshin sipas madhësive të ndërmarrjeve dhe/ose aktiviteteve. Si pasojë kontributi i NVM në eksport është siguruar vetëm për 2002, në kuadër të të dhënave nga vërtetimet e biznesit të siguruara nga QKZh Tiranë. Më tej, ne nuk kemi gjetur informacion të plotë lidhur me numrin e firmave private, sepse repertori ekzistues i ndërmarrjeve përfshin si ato private ashtu dhe ato publike. Megjithatë, për të vlerësuar shkallën e privatizimit në vitet 1997-2000, raporti siguron informacion lidhur me numrin e personave të punësuar në ndërmarrjet private dhe ato publike, i cili është gjithashtu një tregues i mirë për shtrirjen e aktiviteteve private në sektorët e ndryshëm të ekonomisë shqiptare.

1.1. Indikatorët Statistikorë

Në përgjithësi, një zyrë qendrore e statistikave siguron të dhëna për vlerësimin e ndikimit të NVM ne rritjen ekonomike. Këto të dhëna gjenerohen nga Llogaritë Kombëtare. Në këto momente, Sistemi i Llogarive Kombëtare në Shqipëri nuk është akoma i plotë. Për këtë arsye, përgatitja e këtij raporti është bazuar në të dhëna statistikore të cilat janë publikuar në kuadër të “Rezultateve të përgjithëshme të vërtetimeve strukturore vjetore të ndërmarrjeve ekonomike, për vitet 1997-2000”. Rezultatet për 2001 nuk janë akoma të disponueshme. Sipas të dhënave statistikore, të dhënat e siguruara nga këto vërtetime mundohen të kënaqin kërkesën për kompletimin e informacionit statistikor në kushtet e një ekonomie tregu të lirë. Ky sistem mbështetet në deklarinë e ndërmarrjeve².

Për të vlerësuar zhvillimin e aktivitetit të NVM ekziston një numër indikatorësh statistikorë. Në këtë raport ne kemi përdorur indikatorët e mëposhtëm:

1. **Shifra e Afarizimit** nënkupton shumën e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, që i korespondon shitjes në treg të produkteve dhe shërbimeve të ofruara të tretëve. Ky indikator tregon tërësinë e aktivitetit të ndërmarrjes. Në këtë raport, ajo paraqet aktivitetin e biznesit sipas klasave të madhësisë dhe për të gjitha ndërmarrjet. Shifra e afarizimit të një klase madhësie paraqet shumën e shifrave të afarizimit të ndërmarrjeve në këtë klasë madhësie.

¹ Shiko, Observatory of European SMEs, No.2

² Vjetari Statistikor Shqiptar: 1991-1999, INSTAT, 2002, f.244.

TOTAL paraqet tërësinë e ndërmarrjeve dhe është shuma e shifrave të afarizimit të të gjitha klasave të madhësisë.

2. **Investimet** paraqesin vlerën e mallrave afatgjatë të blera nga ndërmarrja ose të realizuara për qëllimet e saj për tu përdorur në një afat jo më të vogël se një vit në procesin e prodhimit, duke përfshirë dhe tokën. Ky indikator tregon stabilitetin e biznesit dhe një të ardhme të begatë. Ndërmarrjet investojnë kur drejtuesit e ndiejnë që biznesi i tyre do të zgjerohet. Indikatori i klasës së madhësisë është shuma e investimeve të ndërmarrjeve të asaj klase madhësie. TOTAL paraqet tërësinë e ndërmarrjeve dhe është shuma e investimeve të gjithë klasave të madhësisë.
3. **Vlera e shtuar** është kontributi i një prodhuesi në PBB dhe përkufizohet si diferencë e shitjes së produkteve dhe blerjes së produkteve nga prodhues të tjerë. Ky indikator është i ngjashëm me Sh.Af. Ndryshimi qëndron në shmangien e taksimit indirekt dhe çmimit të materialeve që përdoren. V.Sh është e rëndësishme për vlerësimin e mbarëvajtjes së prodhimit ose produktivitetit të ndërmarrjes. Indikatori i klasës së madhësisë është shuma e V.Sh të ndërmarrjeve në këtë klasë madhësie. TOTAL paraqet tërësinë e ndërmarrjeve dhe është shuma e V.Sh të gjithë klasave të madhësisë.
4. **Përfitimi i ndërmarrjeve** përcaktohet këtu si diferencë ndërmjet V.Sh dhe kostos së punës, e korrigjuar për pagat e vetë-punësimit të përfshira, dhe paraqitet si përqindje e V.Sh. Në Observatorin Europian të NVM 2002, Nr.2, rekomandohet për të bërë korrigjimin e treguar, sepse është provuar që të vetë-punësuarit përbëjnë një kontribut të konsiderueshëm në ndërmarrjet e tyre, por që nuk pasqyrohen në listë-pagesat. Duke i përjashtuar ata do të vështirësohet një krahasim i NVM (kryesisht për Mikrot) me NMd. Sipas përcaktimit të dhënë për përfitim, ai ndryshon nga fitimi si vlerë, por ata kanë të njëjtin rol në biznesin e ndërmarrjes. Indikatori është llogaritur për secilën klasë madhësie. TOTAL nuk është shuma e të gjithë indikatorëve të klasave të madhësisë, por është llogaritur më vete.
5. **Prodhimtaria e punës** matet si V.Sh për një person të punësuar. Ky është një indikator i llogaritur për secilën klasë madhësie dhe TOTAL. Llogaritet me anë të pjestimit të V.Sh me numrin e të punësuarve për secilin grup ndërmarrjesh. Ky indikator tregon eficientësinë e ndërmarrjes në drejtim të përdorimit të fuqisë punëtore. Vlera e lartë tregon që punonjësit prodhojnë më shumë. Si indikator i llogaritur, ai duhet të vlerësohet për secilën klasë madhësie dhe për TOTAL. TOTAL nuk është shuma e indikatorëve të gjithë klasave të madhësisë.

Gjatë përpunimit të të dhënave statistikore, ne dalluam disa probleme që lidhen kryesisht me paraqitjen dhe saktësinë e të dhënave për çdo vit, pasi ato nuk janë rishikuar në raportet pasuese. E dyta, në disa raste informacioni që jepet për sektorë të veçantë nuk është në përputhje me klasifikimin NACE lidhur me aktivitetet ekonomike. Më tej, disa publikime³ nuk përmbajnë përkufizime të sakta dhe/ose bashkëkohore lidhur me terminologjinë e përdorur. Megjithatë, pavarësisht këtyre problemeve, Raporti përmban një informacion të konsiderueshëm që paraqitet në formë direkte dhe nga indikatorë të llogaritur nga të dhënat statistikore. Këto rezultate, të paraqitura në Raport, janë në përgjithësi të përputhura vit pas viti dhe aty këtu ka disa papajtueshmëri ndërmjet indikatorëve të ndryshëm.

³ Probleme të tilla ne kemi hasur dhe në publikimin e fundit të INSTAT, "Vjetari Statistikor Shqiptar: 1991-1999" Tiranë 2002. Shiko për këtë gjë figurat në faqet 233 dhe 235, tabelat në faqet 236-237, etj.

1.2. Indikatorët e Vrojtimeve të Biznesit

Indikatorët cilësorë gjenerohen nëpërmjet një VB standart. VB janë vëzhgime ekonomike cilësore, që përdoren për: (1) plotësimin e informacionit statistikor kur të dhënat statistikore nuk janë të disponueshme (p.sh. zhvillimet më të fundit për të paktën 3 muajt e kaluar); (2) analizat e parashikimeve ekonomike afatshkurtra (3 deri 6 muaj); (3) identifikimi i pengesave kryesore dhe ndikimi i politikave të ndryshme për biznesin; (4) analiza e ciklit të biznesit. Ndërkohë, modelet ekonometrike konvencionale të ekonomisë kanë efektshmëri relativisht të mirë, kur ekonomia është në një tendencë rritje stabil. Por kur mbarëvajtja e biznesit është me oshilacione ato (modelet ekonometrike) nuk sinjalizojnë sa duhet ndryshimet dhe drejtimet e ardhshme të biznesit. Në këtë drejtim VB kanë një rritje të interesit për të parashikuar pikat e kthesës në ciklin ekonomik.

Vrojtimi i biznesit është një metodë grumbullimi informacioni nga një numër njësisish ose individësh, të cilët formojnë një kampion, në mënyrë që të nxirren konkluzione përfaqësuese lidhur me popullimin, prej të cilit është bërë zgjedhja. Ai ndryshon nga vajtimi statistikor në një aspekt të rëndësishëm, siç është natyra e mbledhjes së informacionit. Më saktësisht, vajtimet e biznesit hartohen për të trajtuar gjykime, vlerësime dhe parashikime të agjentëve ekonomikë – që janë drejtuesit e firmave. Vajtuesit (pjesëmarrësit e vërtetë) sigurojnë informacion jo vetëm lidhur me tendencat e rritjes, por gjithashtu lidhur edhe me ndikimin e faktorëve që influencojnë tek këto zhvillime. Përdorues primare të rezultateve të VB janë institucionet shtetërore, organizatat kërkimore, organizmat ndërkombëtare, universitete dhe publiku i gjërë.

Secili vajtim përbëhet nga një seri pyetjesh me disa zgjedhje, zakonisht me jo më shumë se 5 përgjigje, në shumicën e rasteve me tre. Pyetjet drejtohen me anë të pyetësorëve të parapërgatitur. Më tej, llogariten të ashtuquajturat balanca. Balanca është diferenca ndërmjet përqindjeve të përgjigjeve pozitive dhe negative. Disa pyetje kombinohen që të formojnë një indikator për secilin sektor, industri dhe ndërtim, në këtë raport.

Rëndësia e rezultateve është shumë e madhe dhe ato mund të përdoren në dy mënyra: ose më vete si indikatorë të sentimentit të biznesit dhe konsumatorëve dhe të zhvillimeve ekonomike afat-shkurtra, ose duke u bashkëlidhur me statistikat sasiore për parashikime. Sot, vajtimi i biznesit është pasuar me skemën e harmonizuar të BE, i cili realizohet në mbi 40 vënde në mbarë botën, duke përfshirë dhe vëndet kandidatë të EQL. Integrimi i vajtimeve të tyre në programin e BE është në të njëjtën linjë të integritit të tyre në BE.

Në këtë studim kemi përdorur indikatorët e mëposhtëm të VB:

1. **Indikator i besueshmërisë në industri** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve të pyetjeve: (1) në parashikimin e biznesit, (2) vlerësimin e kërkesave për blerje dhe (3) vlerësimin e gjendjes aktuale të stokut. Ky indikator duhet të kombinojë gjykimet dhe tendencat e aktorëve parësorë, ose prodhuesve, në procesin ekonomik.
2. **Indikator i kërkesave për eksport** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë pyetjes përkatëse.
3. **Indikator i parashikimeve për eksport** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë pyetjes përkatëse.
4. **Indikator i kufizimeve të prodhimit industrial** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë pyetjes përkatëse, dhe lidhet me rreth 16 faktorë pengues, në mjedisin e biznesit, të veprimtarisë së ndërmarrjeve.
5. **Indikator i besueshmërisë në ndërtim** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë pyetjeve: (1) vlerësimi i kërkesave dhe (2) parashikimi i punësimit.

6. **Indikator i kufizimeve të ndërtimit** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë një pyetje, që lidhet me rreth 18 faktorë pengues, në mjedisin e biznesit të veprimtarisë së ndërmarrjeve.
7. **Indikator i investimit** përkufizohet si mesatarja arithmetike e përgjigjeve dhënë pyetjes përkatëse, dhe lidhet me 4 çështje dhe 7 faktorë që pengojnë investimet e ndërmarrjeve.

Përdorimi i VB në rastin e Shqipërisë kufizohet nga arësyet e mëposhtme:

1. Indikatorët e besueshmërisë së biznesit nuk mund të japin vlerësime për tërësinë e ekonomisë shqiptare (përfshirë bujqësinë, që nuk vërtetohet as në EU), sepse rezultatet e vërtetimit janë të vlefshme vetëm për sektorët e industrisë dhe ndërtimit. Rezultatet për tregtinë dhe shërbimet e tjera mund të jenë të disponueshme vetëm në 2003, në se do të gjënden burime financiare të përshtatshme.
2. Informacioni lidhur me sektorin e industrisë, nuk mund të zërthehet më tej për aktivitete brenda këtij sektori – si p.sh. agro-industria, lëkurë-këpuca, tekstili, përpunim druri, etj, sepse madhësia e kampionit është relativisht e vogël dhe nuk lejon paraqitjen e rezultateve, të ndarë sipas aktiviteteve të veçanta brenda një sektori (si ushqimore, druri, lëkurë, tekstile etj).
3. Të dhënat e VB do të jenë të disponueshme deri në shtator 2001 dhe si pasojë ato nuk mund të ofrojnë një informacion, që lidhet me natyrën sezonale dhe ciklike të NVM, sipas madhësisë dhe aktivitetit në Shqipëri. Vazhdimi i VB dhe veçanërisht i vërtetimeve mujore për sektorët (përfshirë bujqësinë), do të lejojë shtrirjen e informacionit lidhur me ndikimin e NVM në rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Gjithashtu, është e rëndësishme për t'u theksuar se Banka e Shqipërisë po tenton paralelisht që të ndërtojë një program të gjenerimit të të dhënave me anë të vërtetimeve të ngjashme.

2. Identifikimi i madhësisë së ndërmarrjeve.

Grupimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është një element kyç i studimit të efektit të NVM në ekonomi. Megjithatë, nuk ka një metodë të vetme dhe përkufizim të bazuar shkencërisht që përcakton një NVM, për deri sa nuk ka një koncept analitik. Për shëmbull, si kriter madhësie po përdoret si shifra e afarizmit ashtu dhe numri i punonjësve në një ndërmarrje. Në këtë raport, si dhe në studime të ngjashme europiane, numri i punonjësve përdoret si kriter i vetëm për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas “klasave të madhësisë”.

Klasifikimi më i përshtatshëm i klasave të madhësisë së ndërmarrjeve varet në synimet që ka një studim. Kështu INSTAT p.sh. përdor klasifikimin e mëposhtëm të ndërmarrjeve:

- Klasa e madhësisë I, punëson 1 deri 4 punonjës
- Klasa e madhësisë II, punëson 5 deri 9 punonjës
- Klasa e madhësisë III, punëson 10 deri 19 punonjës
- Klasa e madhësisë IV, punëson 20 deri 49 punonjës
- Klasa e madhësisë V, punëson mbi 50 punonjës.

Vëndet antare të BE dhe shumica e vëndeve në tranzicion përdorin klasifikimin e mëposhtëm për madhësinë e ndërmarrjeve:

- Mikrondërmarrje, punësojnë 1 deri 9 punonjës
- Ndërmarrjet e vogla, punësojnë 10 deri 49 punonjës
- Ndërmarrjet e mesme, punësojnë 50 deri 249 punonjës
- Ndërmarrjet e mëdha, punësojnë mbi 250 punonjës.

Ligji nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” përdor klasifikimin e mëposhtëm:

- Mikro ndërmarrje, punësojnë deri 5 punonjës
- Ndërmarrjet e vogla, punësojnë 6 deri 20 punonjës
- Ndërmarrjet e mesme, punësojnë 21 deri 80 punonjës.

Në studimin tonë, përdorim klasifikimin e mëposhtëm të ndërmarrjeve:

1. Ndërmarrjet e vogla, punësojnë 1 deri 19 punonjës
 - 1.1. Mikrondërmarrjet, punësojnë 1 deri 4 punonjës (si nën-klasë e ndërmarrjeve të vogla).
2. Ndërmarrjet e mesme, punësojnë 20 deri 49 punonjës
3. Ndërmarrjet e mëdha, punësojnë mbi 50 punonjës
4. NVM-80, punësojnë deri 80 punonjës (përdorur vetëm për VB)

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e mikrondërmarrjeve në ekonominë shqiptare (shiko Tabelën 1), raporti siguron një informacion shtesë për mikrondërmarrjet që punësojnë 1 – 4 punonjës.

Zgjedhja e klasave të madhësisë së ndërmarrjeve si më sipër bazohet gjithashtu në argumentat e mëposhtëm:

- i. **Madhësia e ekonomisë shqiptare** është shumë e vogël në krahasim me madhësinë mesatare të vendeve të tjera europiane dhe si rrjedhim ne kemi konsideruar si ndërmarrje të mëdha ato, të cilat mesatarisht punësojnë mbi 50 vetë. Ndërmarrjet e tjera konsiderohen të vogla dhe të mesme. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e ndërmarrjeve të vogla, Raporti, kur është e mundur, siguron informacion për mikrondërmarrjet, që punësojnë 1 – 4 vetë. Ndërmarrjet e mesme punësojnë 20 – 49 vetë.
- ii. Zgjedhja e strukturës së madhësisë merr në konsideratë nevojat për **harmonizimin e ardhshëm me standardet e BE dhe nevojën e sigurimit të krahasueshmërisë në kohë dhe me të gjithë vendet**. Klasifikimi struktural i zgjedhur lejon një transformim të lehtë të të dhënave lidhur me zhvillimin e NVM në Shqipëri në përputhje me standartet e BE.
- iii. **Kostoja totale e projektit** dhe relativisht **koha e shkurtër** për kompletimin e këtij projekti (2 muaj) kanë ndikuar në njëfarë mase për të mos zgjeruar “klasën e madhësisë”.
- iv. Nevoja për të **harmonizuar të dhënat statistikore** me ato të siguruar nga VB. Zgjerimi i klasave të madhësisë për të dhënat e VB është e mundur vetëm nëse madhësia e kampionit do të rritet në të ardhmen.
- v. **Ligji “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”** ka hyrë në fuqi në fund të nëntorit, kështu nuk ka qënë e mundur për të patur të dhëna sipas përcaktimeve të ligjit mbi klasat e madhësisë. Për të harmonizuar raportin me përcaktimin e ligjit të NVM, indikatorët e VB u vlerësuan vetëm për grupin e ndërmarrjeve që punësonin deri 80 vetë. Nuk ka përkufizim ligjor (më sipër).

VLERËSIMI I ZHVILLIMIT TË NVM-VE, 1997-2000

1. Vrojtim i përgjithshëm për rëndësinë e NVM

Tabela 1 tregon peshën dhe rëndësinë e NVM në ekonominë shqiptare e shprehur nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat⁴ (përfshijtur bujqësinë), si dhe kontributin në formacionin e të ardhurave kombëtare. Në vitin 2000, NVM përfshijnë rreth 99 përqind të repertorit të ndërmarrjeve në Shqipëri. Mbi 35100 ndërmarrje të vogla dhe të mesme sigurojnë rreth 77200 të punësuar në Shqipëri. Mbi 91.1 % e ndërmarrjeve punësojnë më pak se 4 vetë dhe për këtë arsye ato janë klasifikuar si mikrondërmarrje. Si mesatare të gjitha ndërmarrjet në Shqipëri punësojnë rreth 4 vetë. Këto shifra varjojnë mesatarisht nga 1,9 në ndërmarrjet e vogla, në 31.4 në ndërmarrjet e mesme. Shifra e afarizmit ka një variacion të madh ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Si mesatare, ndërmarrjet e vogla kanë regjistruar një shifër afarizmi rreth 4.6 milion lekë, krahasuar me 108 milion lekë⁵ që kanë deklaruar firmat e mesme. Fuqia punëtore është më produktive në ndërmarrjet e mesme (e matur nga vlera e shtuar për punonjës). Si mesatare, një punonjës në ndërmarrjet e mesme ka siguruar jo më pak se 8000 lekë, ose 2700 lekë më shumë se mesatarja.

Tabela 1: Rëndësia ekonomike e NVM, 2000

Indikatorët		NVM-t			
		Mikro	Të vogla*	Të mesme	TOTAL**
Numri i ndërmarrjeve	(1000)	37.2	34.8	0.3	35.5
Punësimi	(1000)	49.1	66.4	10.8	144
Të punësuar për ndërmarrje		1.5	1.9	31.4	4.0
Shifra afarizmit për ndërmarrje	Milion lekë	3.2	4.6	108.0	7.9
Vlera e shtuar për të punësuar	Milion lekë	0.46	0.48	0.80	0.53

Burimi: INSTAT

* Ndërmarrjet e vogla përfshijnë dhe mikrondërmarrjet

** TOTAL përfshin dhe ndërmarrjet e mëdha

Figurat 1 dhe 2 tregojnë ndryshimet vjetore në strukturën e ndërmarrjeve, në periudhën 1997-2000, dhe ndikimin e madhësisë së ndërmarrjeve në rritjen ekonomike dhe përfitimin. Përfitimi, i cili jepet në përqindje të V.Sh, si diferencë ndërmjet V.Sh dhe kostos së punës, e korrigjuar për të ardhurën e pagave të vetë-punësimit.



Figura 1 tregon se gjatë periudhës 1997-2000 struktura tërësore e NVM (e vlerësuar si përqindje e Sh.Af sipas madhësisë së ndërmarrjes) ndryshon në favor të NVM. Struktura e Sh.Af për NVM është rritur nga 7.8 % në 1997, në 13.3% në 2000. Në të njëjtën kohë, struktura e NVM është zvogëluar në 37.5 %, nga 43.7% në 1999.

Figura 2 tregon se ndryshimet në NV vijnë nga humbja e ndjeshme e mikrondërmarrjeve. Figura tregon gjithashtu që sipas përfitimit, NMs janë grupi i ndërmarrjeve më dinamike. Në vitin 1998 përfitimi i tyre rritet 15 % më shumë se përfitimi mesatar për tërësinë e ndërmarrjeve dhe rreth 11 % në 1999. Në 2000 NMs janë ndërmarrjet më fitimprurëse dhe janë menaxhuar për të patur një


⁴ Në 1999, sektori privat, përfshijtur bujqësinë, punësonte 102 675 vetë, ose 10 përqind të punësimit total në Shqipëri [INSTAT 2002, Tabela 4, f.98].

⁵ Kursi aktual i këmbimit është 1 \$ = 130 lekë

përfitim konstant, ndërsa ndërmarrjet e klasave të tjera të madhësisë (përfshirë dhe NMD) patën rritje negative.



Të dhënat e VB për sektorin e industrisë tregojnë që në 2002 NMs janë duke patur mbarëvajtje mjaft më të mirë se sa NV, por ato mbeten mjaft mbrapa NMD (shiko Figurën 3). Në janar 2002, shumica e drejtuesve të NV mendojnë që prodhimi i tyre është ulur në krahasim me tre muaj më parë. Balanca⁶ e përgjigjeve është negative me 62 pikë. Në maj 2002, përgjigjet e marra nga NMD ndikojnë për të rritur përqindjen e totalit të përgjigjeve me 30 pikë. NMD janë ende duke patur një mbarëvajtje më të mirë në tetor 2002. Kjo pasqyrohet me diferencën ndërmjet përqindjeve të përgjigjeve pozitive dhe negative për NMD, e cila është me 50 pikë. Për NMs kjo diferencë është pozitive me 41 pikë, ndërsa mbetet pothuaj e pandryshuar balanca për NV.



2. Krahasimi me NVM europiane.

Në BE, 20 milion ndërmarrje përbëjnë forcën lëvizëse drejt prosperitetit ekonomik. Ato sigurojnë punësim për mbi 120 milion vetë. Shumica e këtyre ndërmarrjeve janë NVM. Shifrat e paraqitura në tabelat që pasojnë përjashtojnë ndërmarrjet bujqësore dhe të peshkimit.

Analizat në nivel makro tregohen në Tabelën 2. Për ndryshimet në klasat e madhësisë të përdorura në Raport dhe ato të BE, këto tabela paraqesin krahasimin për numrin total të ndërmarrjeve duke përfshirë dhe NMD dhe vetëm për indikatorët që mund të krahasohen bazuar në të dhënat e disponueshme statistikore.

⁶ Balanca tregon diferencën ndërmjet përqindjeve të përgjigjeve negative dhe positive.

Tabela 2: Indikatorët kryesorë bazuar tek numri total i ndërmarrjeve në Europë-19 dhe Shqipëri, 2000

Indikatorët		BE-19	Shqipëria
Numri i ndërmarrjeve	(000)	20,455	35.5
Punësimi	(000)	121,750	144
Të punësuar për ndërmarrje		6	4
Shifra e Afarizmit për ndërmarrje	Milion Euro	1.1	0.06
Vlera e Shtuar për të punësuar	Mijë Euro	80	3.8
Pjesa e kostos punës ndaj Vlerës Shtuar	%	56	33.1

Burimi: INSTAT dhe European Commission 2002

Struktura sipas grupimit të vëndeve tregohet në Tabelën 3. Pjesa më e madhe në totalin e punësimit tregon dominimin e klasave të madhësisë mikro të ndërmarrjeve.

Tabela 3: Struktura e të gjitha Vëndeve Kandidate, Shqipëria dhe Europe -19, 1999

	Ndërmarrjet (1 000)	Numri total i të punësuarve (1 000)	Madhësia mesatare e ndërmarrjeve	Madhësia (Klasa) Dominuese
BE	19,930	n.a.	6	Mikro
Jo në-BE	525	n.a.	7	NVM
Europe-19	20,100	120,000	6	Mikro
Të gjitha Vëndet Kandidate	5,805	29,290	5	Mikro
Shqipëria	35.7	148	4.15	Mikro

Burimi: INSTAT dhe European Commission 2002

Tabela 4 tregon se brenda vëndeve kandidate, ekzistojnë diferenca të mëdha ndërmjet madhësisë mesatare të ndërmarrjes. Analiza e zhvillimeve ndërmjet 1995 dhe 1999 tregon që madhësia mesatare në këto vëndeve tenton të arrijë drejt Europës-19. Disa nga vëndet që kanë një madhësi mesatare të ndërmarrjes të ulët, kanë pësuar një rritje në madhësinë mesatare të ndërmarrjes. Kjo qëndron dhe me faktin se struktura e këtyre ekonomive është më e përshtatur me BE-n.

Tabela 4: Madhësia mesatare e ndërmarrjeve, Vëndet Kandidate, Shqipëria, dhe Europa-19, 1998-2000

	1999	Ndryshimet 1995-1999
Shqipëria*	4.15	-0.76**
Bullgaria	8	-0
Qipro	4	-0
Republika e Çekisë	5	-2
Estonia	9	-2
Hungaria	4	-5
Letonia	15	-2
Lituania	11	-1
Malta	4	0
Polonia	5	-0
Rumania	6	2
Republika Sllovaqe	8	-0
Sllovenia	6	-0
Turqia	4	0
Të gjitha Vëndet Kandidate	5	-1
Europa-19	6	-0

* Shqipëria nuk është përfshirë në Vëndet Kandidate

** Ndryshimet gjatë 1997-2000

Burimi: INSTAT dhe European Commission 2002

3. Ndikimi i privatizimit

Për të analizuar zhvillimin e ndërmarrjeve private për periudhën që studjohet 1997-2000 dhe ndikimin e privatizimit në ndryshimin e strukturës të ndërmarrjeve private dhe kontributin në V.Sh, është e rëndësishme të merret informacion mbi ndryshimet e numrit të ndërmarrjeve sipas madhësisë, pronësisë dhe aktivitetit. Sipas hulumtimeve tona, kryesisht në publikimet e INSTAT dhe institucioneve të tjera, ne nuk gjetëm informacion të vlefshëm për të plotësuar këtë detyrë. Megjithatë, publikimet e INSTAT-it përmbajnë disa informacione lidhur me ndryshimin e punësimit në ndërmarrjet private dhe publike sipas sektorëve⁷. Duke marrë në konsideratë që punësimi është njëri nga komponentët kryesorë në faktorët e prodhimit (duke konsideruar që teknologjia nuk ka ndryshuar në perjudhën që studiohet 1997-2000), ne mund të konsiderojmë që ky indikator është përafëri më i mirë për të treguar ndryshimin e pronësisë private, po ashtu dhe për vlerësimin e ndikimit të privatizimit në këto ndryshime. Figura 4 përmbledh ndryshimet e punësimit sipas pronësisë së ndërmarrjeve në aktivitetet jo bujqësore.




Figura 4 tregon që në 1997 punësimi në ndërmarrjet publike ishte 38% e punësimit total në sektorët, përjashtuar bujqësinë⁸. Në 1998 pjesa e punësimit në ndërmarrjet publike u rrit me 6%, kryesisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të aktivitetit publik në transport (me rreth 13000 punonjës) dhe të shërbimeve. Pjesa e punësimit nga ndërmarrjet publike në industri u rrit gjithashtu nga 57 % në 60 %. Këto ndryshime mund të shpjegohen me keqësimin e gjendjes në 1997 të klimës biznesit në Shqipëri, e cila kushtëzoi që një pjesë e punonjësve të zhvendoset drejt ndërmarrjeve publike.

Në vitin 1999 struktura e punësimit ndryshoi rrënjësisht. Pjesa e punësimit në sektorët privatë në industri u ngrit nga 40 në 51 %, në ndërtim u rrit me 12 % dhe pjesa e punësimit privat në shërbimet u ngrit nga 74% në 1998 në 84% në 1999. Këto ndryshime mund të shpjegohen me përshpejtimin e programit të privatizimit nga qeveria, i cili ishte ndalur gjatë viteve 1997 dhe 1998. Në 2000, struktura e pronësisë së ndërmarrjeve nuk ka shënuar ndryshime të dukshme. Në fakt punësimi i përgjithshëm, në sektorët jo bujqësor, në 2000 krahasuar me 1999 ka patur ulje me 3%.

⁷ Zbërthimi i këtyre informacioneve sipas madhësisë së ndërmarrjeve nuk ishte i mundur

⁸ Në totalin e ndërmarrjeve publike dhe private ishin të punësuar 134 110 vetë [INSTAT, 2000(a), Tabela për punësimin f. 2 dhe 6]


4. Ndikimi i madhësisë së ndërmarrjeve në rritjen ekonomike

Analiza e ndikimit të NVM në rritjen ekonomike lidhet me të ashtuquajturin rivlerësim i sektorit të ndërmarrjeve private, përjashtuar bujqësinë, sipas termave të strukturës, rritjes dhe mbarëvajtjes. Në këtë seksion duke përdorur indikatorët që pasojnë, në varësi të madhësisë së ndërmarrjes, do të vlerësojmë ndryshimet vjetore të strukturës dhe të rritjes nëpërmjet indikatorëve:

- (a) Shifra a afarizmit
- (b) Vlera a shtuar
- (c) Numri i punonjësve
- (d) Numri i ndërmarrjeve

4.1. Shifra e afarizmit

Figura 5 tregon ndryshimet në strukturën e shifrës së afarizmit sipas madhësisë në periudhën 1997-2000. Mund të dallohet që gjatë periudhës 1997-2000 më shumë se gjysma e shifrës së afarizmit është rezultat i aktivitetit të NV dhe 2/3 e saj realizohen nga Mikro (shiko Figurën 6)



Duke vështruar Figurën 5 mund të dallohet që pesha e NMs është rritur nga 8 % në 1997, në 10 % në 1999 dhe më tej në 13 % në 2000. Figura 5 tregon gjithashtu që NMD janë zvogluar nga 33 % në 1997, në 29 % në 2000. Gjatë periudhës 1997-2000 struktura e NV ka mbetur konstante. Megjithatë, brenda këtij grupi madhesia e Mikro është tkurrur nga 40 % në 1997, në 37 % në 2000 (shiko Figurën 6).






Figura 7 tregon se gjatë periudhës 1997-2000 tendenca e rritjes së shifrës së afarizmit është e ndryshme për të tre klasat e madhësisë. NMs kanë patur mbarëvajtje më të mirë se NV dhe NMD dhe siç duket ato janë firmat më dinamike në ekonominë shqiptare.

Gjatë periudhës që studiohet 1997-2000, ndryshimi vjetor i shifrës së afarizmit për ndërmarrjet e mesme ishte respektivisht 34, 64 dhe 49%, Këto shifra tregojnë që rritja e NMs ka patur një ndikim të rëndësishëm në nivelin e rritjes totale të Sh.Af. NV kanë patur një mbarëvajtje më të mirë në 1998 dhe 1999, por ato janë rritur më pak se sa mesatarja e ndërmarrjeve në 2000. Figura 7



tregon që rritimi i rritjes për NMs ka ndryshuar në periudhën 1997-2000. Pas një rritje të menjëhershme në 1998 prej 60 % ato zbresin me 10 % në 1999 dhe kanë patur një mbarëvajtje të arsyeshme në 2000 (janë rritur rreth 20%).

Figura 8 tregon që rënia e NV është rezultat i zhvillimeve brenda Mikro (që punësojnë 1-4 vetë). Rritja negative për Mikro mund të shpjegohet me ndryshimet në mjedisin e biznesit për këto ndërmarrje pas vitit 2000. Rritja e taksave për biznesin e vogël dhe bariera të tjera administrative do të ketë qenë faktori pengues në rritimin e rritjes së NV.




Analiza e Sh.Af sipas madhësisë tregon se gjatë periudhës 1997-2000 indikatorin e madhësisë së ndërmarrjeve është në korelacion pozitiv me rritjen vetëm për NMs (që punësojnë 20-50 vetë), dhe ka korelacion negativ për Mikro. Si konkluzion mund të shprehemi se gjatë viteve 1997-2000, NMs u bënë grupi më i rëndësishëm i ndërmarrjeve dhe struktura më e preferuar për menaxherët në Shqipëri.


Konkluzion: NMs, gjatë periudhës 1997-2000, u bënë një grup i rëndësishëm, sepse paraqesin një rritje konstante të indikatorit të Sh.Af. NV, gjatë periudhës 1997-2000, e pakësuan aktivitetin e tyre dhe u bënë më të parëndësishme për rritjen ekonomike. Ndikimi i NV dhe NMs ka kontribuar negativisht në indikatorin e Sh.Af për TOTAL-in.

4.2. Vlera e shtuar

Shuma e çmimeve të produkteve (ose shërbimeve) që shiten, paraqet koston e lëndëve të para ose shërbimeve që i kryhen, plus vlerën që i shtohet. V.Sh paraqet pjesën e mbikostos së bashku me fitimin. Çmimi i shitjes, ose shifra e afarizmit, për produktin (ose shërbimin) paraqet vlerën e tij tek klientët. V.Sh paraqet atë pjesë sipas së cilës kontribon biznesi në krijimin e pasurisë kombëtare.




Për të vlerësuar ndryshimet e veprimitarisë së ndërmarrjeve sipas madhësisë, V.Sh është indikator më i përshtatshëm se sa Sh.Af. Kjo për arsye se në V.Sh ndikimi i taksimit indirekt dhe çmimi i materialeve përjashtohen. Nga figura 9 shikohet se kontributi në V.Sh i NMD e ka humbur rëndësinë e tyre. Gjatë periudhës 1997-2000 kontributi i tyre në V.Sh u zvoglua në 47% për vitin 2000, krahasuar me 52% për vitin 1997.



Kontributi i NMs në V.Sh u dyfishua për periudhën 1997-2000, ndërkohë pjesa e kontributit për NV mbeti pothuaj e pandryshuar.

Duke ju referuar indikatorit të rritjes vjetore të V.Sh, rezultatet tregojnë që për 2000, NV dhe veçanërisht Mikro kanë patur një rritje negative (shiko Figurat 9 dhe 10).

Figura 10 tregon që ritmi i rritjes për NMs për të tre vitet është më i lartë se rritja mesatare për të gjithë ndërmarrjet. Në 2000, ato u rritën me rreth 17 %, ose 11 % më shumë se vlera mesatare e V.Sh për të gjithë sektorët.



Diferencat në kontributin e V.Sh sipas madhësisë së ndërmarrjes janë më të dukshme se në vendet e tjera të Europës. Sipas Raportit të “Observatorit Europjan të NVM-ve, 2002, nr.2”, kontributi i V.Sh ka nje korelacion pozitiv me madhësinë e ndërmarrjes. Figurat 9, 10 dhe 11, tregojnë se në Shqipëri ky relacion është më i fortë për NMs.

Konkluzion: Kontributi i NMs është dyfishuar për perjudhën 1997-2000, ndërsa pjesa e kontributit nga NV ka mbetur pothuaj i pandryshuar. NMs kanë patur një ritëm rritje më të lartë se rritja mesatare për të gjitha ndërmarrjet (paraqitur ne grafik nga TOTAL). Korelacioni i V.Sh me madhësinë e ndërmarrjes është më i fortë për NMs, duke treguar që sjellja e kësaj klase madhësie i përshtatet më mirë kontributit

4.3. Numri i të punësuarve

Pas analizës se Sh.Af dhe V.Sh le të shikojmë në se konkluzioni lidhur me rritjen e rëndësisë së NMs mbështetet nga dy indikatorët e tjerë, numrit të punonjësve dhe të ndërmarrjeve sipas madhësisë së tyre.





Figura 12 siguron informacionin lidhur me ndryshimet në numrin e punonjësve sipas madhësisë së ndërmarrjeve në përqindje të totalit. Duket që në 2000, struktura e punësimit nga NVM në total është rritur me 53 % nga 47 % në 1997. Në të njëjtën kohë pjesa e punësimit për NMD është zvogluar në 46 % në 2000, prej 53 % në 1997. Këto rezultate tregojnë që gjatë perjudhës 1997-2000 punonjësit ishin duke lëvizur nga NMD drejt NV dhe NMs.

Figura 13 nxjerr në pah ritmin e rritjes së punonjësve sipas madhësisë së ndërmarrjes. Mund të vihet re që gjatë perjudhës 1997-2000, dhe veçanërisht 1999 dhe 2000, numri i të punësuarve në NMs ka patur vazhdimisht rritje. Në 2000, p.sh. punësimi në NMs pothuaj se e zhvendos efektin negativ të




rritjes së punësimit nga NV dhe sidomos nga NMd.

Indikatori për Mikro është pothuajse i njëjtë si indikatori për NV.


Konkluzion: Numri i të punësuarve ka qenë në rritje të vazhduar në NMs, sidomos gjatë 1999-2000. NV dhe NMd kanë efekt negativ në punësim kundrejt TOTAL-it të numrit të ndërmarrjeve.

4.4. Numri i ndërmarrjeve


Figura 14 siguron informacion lidhur me numrin e ndërmarrjeve sipas madhësisë në përqindje të totalit. NV përfaqësojnë rreth 98 % të repertorit të ndërmarrjeve në Shqipëri dhe nga kjo rreth 92 % e tyre janë mikrondërmarrje (shiko Figurën 15). Pjesa e NMs dhe NMd është pothuajse e njëjtë. Megjithatë, në se i referohemi shifrave të rritjes vjetore për periudhën 1997-2000 (Figura 16), disa zhvillime të rëndësishme mund të dallohen.



Gjatë periudhës 1997-2000, ritmi i rritjes së ndërmarrjeve për NV dhe NMd është vazhdimisht në zvogëlim dhe bëhet negativ për vitin 2000. Në 2000, NMd zvogëlohen me 11 % dhe NV me 1 %. Për të njëjtën periudhë vetëm numri i NMs ka qenë në rritje. Ato u rritën me 10 % në 1999 dhe 21 % në 2000.



Si konkluzion për këtë seksion, mund të thuhet se gjatë periudhës 1997-2000, të gjithë indikatorët e analizuar, si Sh.Af, V.Sh, punësimi dhe numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë, tregojnë që NMs janë ndërmarrjet më dinamike, të cilat kanë dhënë shumicën e rritjes dhe si rrjedhojë, sipas numrit të të punësuarve ato janë struktura më e preferuar e ndërmarrjeve.



Aneksi 2 siguron informacion për të njejtët indikatorë, por të ndarë sipas sektorëve – ato janë: industri, ndërtim, tregti dhe shërbime të tjera.

Konkluzione: Numri i NV dhe NMs ka ardhur vazhdimisht në zvoglim gjatë periudhës 1997-2000. Për të njejtën periudhë numri i NMs ka patur rritje. Rritja e numrit të NMs ka kontribuar në shumicën e rritjes, duke theksuar që kjo klasë madhësie është më dinamike dhe struktura më e preferuar e ndërmarrjeve.

4.5. Rritja e investimeve

Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve janë një indikator i rëndësishëm, i cili tregon perspektivën e rritjes për klasat e ndryshme të ndërmarrjeve. Duke marrë në konsideratë periudhën e studimit 1997-2000, mund të thuhet se viti bazë 1997 është pika më e ulët për aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve në Shqipëri dhe rrjedhimisht duhet pritur që investimet në 1998 të jenë rritur.





Figura 17 tregon strukturën e investimeve sipas madhësisë. Investimet më të shumta janë kryer nga NMD, por pjesa e tyre kundrejt totalit, pas një rritje të madhe në 1998, tregojnë një ulje të vazhduar, 55 % në 1999 dhe 50 % në 2000. Këto zhvillime mund të shpjegohen me faktin që pas tronditjes së 1997, NMD kanë qenë më të afta për të ndërmarrë programe investimi. Niveli i investimeve të NVM, pas uljes së investimeve në 1998, pothuaj arritën nivelin e investimeve të NMD.

Rritimi i rritjes vjetore sipas madhësisë së ndërmarrjeve, tregon gjithashtu një paraqitje të ndryshme. Figura 18 tregon që në 1998, investimet e NMs dhe veçanërisht NMD janë rritur më shumë se niveli i NV.



Në 1999, investimet në sektorin e NVM ka tejkaluar atë të NMD. Në 2000, investimet totale janë ulur me 25%. Vetëm NMs në 2000 kanë rritur nivelin e investimeve, krahasuar me nivelin e 1999. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet fakti që ulja e investimeve për dy klasat e tjera është mjaft më e lartë, respektivisht 25% për NMD dhe 21% për NV.

Konkluzione: NMD kanë realizuar shumicën e investimeve gjatë periudhës 1997-2000, sepse pas tronditjes së 1997 këto ndërmarrje kanë qenë më të afta për të ndërmarrë programe investimi. Në vitet që pasojnë, investimet nga NMD kanë treguar një rënie të vazhdueshme. Vetëm NMs kanë ndërmarrë programe investimi të vazhdueshme dhe pjesa e tyre ka arritur duke u rritur.

4.6. Prodhimtaria

Prodhimtaria matet si V.Sh për një të punësuar dhe faktikisht është e pritshme që vlera për një të punësuar të ketë një korelacion pozitiv me madhësinë e ndërmarrjes⁹ Nga tabela 5, produktiviteti varion ndërmjet klasave të ndryshme të ndërmarrjeve vit pas viti. Për 1997 është e pritshme që produktiviteti të jetë në pikën më të ulët dhe që varion në kufi të ngushtë, nga 0.29 milion lekë në Mikro, në 0.32 milion lekë për NMs.

Tabela 5: Prodhimtaria sipas madhësisë ndërmarrjeve, 1997-2000
Milion lekë

	1997	1998	1999	2000
Vogla	0.31	0.39	0.47	0.48
Mikro	0.29	0.39	0.48	0.46
Mesme	0.32	0.60	0.92	0.80
Mëdha	0.30	0.29	0.47	0.54
TOTAL	0.31	0.35	0.49	0.53

Burimi: INSTAT

Tabela 5 tregon që prodhimtaria nuk lidhet me madhësinë e ndërmarrjes. NMs janë sërish ndërmarrjet më të mira dhe janë drejtuar që të krijojnë një strukturë efektive sipas indikatorit të arritjes së niveleve të prodhimtarisë me shkallën më të lartë të efikasitetit. Në 1998 dhe 1999, NMs, të cilat mund të rregullojnë më mirë nivelet e prodhimit dhe punësimit, përputhen me shkallën minimale të efikasitetit. Në 2002, diferenca e prodhimtarisë ndërmjet NV dhe Mikro tregon që me një numër më të lartë punonjësish, ndërmarrjet janë më të afta të rregullojnë nivelin e prodhimit dhe kostos së tyre.






Figura 19 tregon ndryshimin vjetor të V.Sh për një të punësuar. Në 1998, prodhimtaria e NMs është rritur 87 %, e cila është mjaft më e lartë se nivelet e arritura nga klasat e tjera. Prodhimtaria e NMs është rritur negativisht me 4 %. Në 1999, NMs gjithashtu kanë rritur prodhimtarinë, por ndërmarrjet e mëdha zhvillojnë veprimtarinë mjaft më mirë sipas termit të prodhimtarisë, i cili është rritur me 61 %.

⁹ Sipas Öservatorit European të NVM 2002, në 2002 në nivelin european ka një korelacion të fortë ndërmjet madhësisë së ndërmarrjes dhe produktivitetit.

Mikro ndërmarrjet kanë ndikuar prodhimatarinë e NV vetëm në 2000, kurse prodhimtaria në Mikro ndërmarrjet është rritur negativisht me 4 % (shiko Figurën 20).



Në një kuptim më të gjërë ndryshimet në prodhimtari mund të shpjegohen me dy faktorë: - ato janë ndryshime të pjesës së kostos së punës kundrejt V.Sh dhe ndryshimeve në teknologji. Figura 21 tregon dinamikën e pjesës së kostos së punës ndaj V.Sh gjatë periudhës 1997-2000. Duke krahasuar rezultatet e Figurave 19 dhe 21 mund të thuhet që ndryshimet në prodhimtari mund të shpjegohen me ndryshimet e pjesës së kostos së punës në V.Sh dhe më pak ndaj ndryshimeve në nivelin e teknologjisë. Figura 21, p.sh. tregon që në 2000, të gjitha klasat e ndërmarrjeve kanë rritur koston e punës, e cila pasohet me një zvoglim të ndieshëm në prodhimtari (shiko Figurën 19).



Si përfundim, mund të thuhet që NVM në Shqipëri, sipas termave të prodhimtarisë janë të varura nga kosto e punës, që përdoret me efektivitet nga NMs. Përderisa ndryshimet e prodhimtarisë shpjegohen më gjërësisht nga kostoja e punës, mund të çojë në përfundimin që firmat nuk po investojnë akoma për teknologji të re që të rrisin prodhimtarinë.

Konkluzione: NMs kanë arritur shkallën maksimale të efektivitetit. NV, përfshi dhe Mikro, janë më të afta për të rregulluar nivelet dhe kostot e prodhimit. Analiza e produktivitetit tregon që pjesa e kostos së punës në V.Sh është më e lartë se pjesa e nivelit teknologjik. Për vitin 2000 të gjitha klasat e ndërmarrjeve e kanë rritur koston e punës, gjë që ka ndikuar në reduktimin e prodhimtarisë. Reduktimi i prodhimtarisë është pasojë e mungesës së investimeve për teknologji të reja.

4.7. Përfitimi i ndërmarrjeve

Si dhe në Raportin e 2002, të Observatorit European të NVM, përkufizohet përfitimi për veprimtarinë, duke u korigjuar për pagat e të vetë-punësuarve, e shprehur si përqindje ndaj V.Sh. Përfitimi i ndërmarrjeve llogaritet si diferencë e V.Sh dhe kostos punës. Në bazë të metodologjisë Europiane rekomandohet për të bërë një korigjim për vlerën e pagave të të vetë-punësuarve tek mesatarja e pagave sipas klasave të madhësisë shumëzuar me numrin e të vetë-punësuarve. Ky korigjim kërkohet, sepse të vetë-punësuarit sigurojnë një kontribut pune që është i rëndësishëm për ndërmarrjen e tyre, por që nuk figuron në llogarinë e zakonshme. Duke e përjashtuar atë bëhet më i vështirë krahasimi i NVM (veçanërisht Mikro) me NMD.

Është e pritshme që prodhimtaria e punës dhe përfitimi i ndërmarrjeve të kenë një korelacion të drejtpërdrejtë dhe si rrjedhim është e pritshme që NMs të jenë klasa e ndërmarrjeve më fitimprurëse. Ndërkohë që Figura 22 tregon se në 2000 ndërmarrjet me përfitimin më të madh janë Mikro (që punësojnë 1-4 vetë), gjë që është një rezultat i çuditshëm në se konsiderojmë që nga ky grupim të ketë korelacion negativ me përfitimin.





Figura 22 tregon që NVM, sipas V.Sh, janë 20 % më përfituese se sa NMD. NMs janë shumë afër përfitimit mesatar të NVM, me 80 %.

Figura 23 tregon që në 1998, përfitimi i NVM është rritur 8 % për NV, 7 % për Mikro dhe 15 % për NMs. Në 1999, përfitimi i NMD ka ndikuar në rritjen e përfitimit të NVM, por në 2000 ato janë ende mbrapa nivelit të përfitimit të NMs, të cilat kanë patur një rritje konstante për këtë vit, ndërsa ndërmarrjet e tjera kanë patur një rritje negative prej 2 %.



Konkluzione: Analiza tregon që Mikro ndërmarrjet janë më përfitueset në vitin 2000. Ky rezultat është i çuditshëm, sepse madhësia ka korelacion negativ me përfitimin. NMs janë pranë përfitimit mesatar të NVM. Në vitin 1999, NMD kanë kontribuar në rritjen e përfitimit të NVM, por në 2000 ato janë ende mbrapa nivelit të përfitimit të NMs.

Kapitulli 3

VLERËSIMI I ZHVILLIMEVE TË FUNDIT TË NVM DUKE PËRDORUR REZULTATET E VB

1. Parathënie për vrojtimit e biznesit

Arësyeja e kryerjes së VB cilësore është e qartë: për të rritur nivelin e informacionit lidhur me perceptimin e biznesmenëve për mjedisin dhe transmetimin e një informacioni të tillë për politikë-bërësit dhe të interesuarit e tjerë. Karakteristika më e rëndësishme e VB është e lidhur me faktin që ato janë të disponueshme me një herë dhe relativisht me kosto të ulët. Këto karakteristika e bëjnë të mundur që VB të sigurojnë:

- 1.1.** Informacion statistikor komplementar, kur të dhënat statistikore nuk janë të disponueshme (p.sh. paraqesin zhvillimet e 3 muajve të fundit).
- 1.2.** Analiza të parashkimit afat-shkurtër ekonomik (në kombinim me të dhënat statistikore).
- 1.3.** Identifikimin e kufizimeve kryesore dhe ndikimin e politikave të ndryshme për biznesin.
- 1.4.** Analizën e ciklit të biznesit. Vrojtimit e biznesit janë të disponueshme për vitin 2002, të cilat janë përdorur në seksionin që pason, për të vlerësuar zhvillimin e NVM në sektorin e industrisë dhe të ndërtimit.

Rezultatet e VB paraqiten në formë të tillë që të tregojnë qartë opinionin lidhur me ndryshimet aktuale, ose gjykimet për nivelin e një numri variablash. Në këtë mënyrë vrojtimit kapin drejtimet e ndryshimeve për një aktivitet të veçantë.

2. Zhvillimet e fundit në sektorin e industrisë

2.1. Indikator i besueshmërisë për industrinë

Indikator i besueshmërisë është një formë e indikatorëve të përbërë, të cilët përdoren për të lehtësuar interpretimin e rezultateve të VB, duke shumuar përgjigjet për variabla të ndryshëm në një numër të vetëm dhe në një seri kohore të thjeshtë. Indikator i besueshmërisë për industrinë përkufizohet si mesatare arithmetike e përgjigjeve lidhur me pyetjet mbi parashikimet e biznesit, vlerësimit të kërkesave për blerje dhe vlerësimit të gjendjes aktuale të stokut (me shënjë të ndryshuar). Paraprakisht duhen sqaruar supozimet e më poshtme:

- Kombinim i këtyre tre variablave përmbledh me saktësi klimën industriale.
- Klima industriale lidhet pozitivisht me rritjen e balancave për vështrimin e prodhimit dhe të kërkesave të blerjes dhe me zvoglimin e balancës për gjendjen aktuale të stokut.
- Të tre variablat kanë saktësisht të njëjtën peshë në formulimin e klimës për industrinë.

Figura 24 tregon një rritje të vazhduar të indikatorit të besueshmërisë për sektorin e industrisë, respektivisht 6 % në janar, 10 % në maj dhe 11 % në tetor 2002. Këto shifra tregojnë që gjatë 2002 ka një rritje të vazhduar të optimizmit të drejtuesve në sektorin e industrisë. Ky indikator është vlerësuar për TOTAL. Figura 25 tregon indikatorin e besueshmërisë për NVM-80. Vihen re disa

diferenca ndërmjet indikatorëve të grupeve të ndryshme të ndërmarrjeve. Këto diferenca vijnë nga pjesa e NMD që punësojnë mbi 80 vetë.






Figura 26 tregon ndikimin e secilit përbërës të indikatorit të besueshmërisë. Në janar dhe tetor 2002, balanca e përgjigjeve tregon që kemi një ulje të produktit të gatshëm, i cili kanë qenë faktori parësor që ka ndikuar në rritjen e indikatorit të besueshmërisë për aktivitetin industrial, me 6 dhe 11 %. Në prill 2002, rritja e parashikimit të biznesit me 35 pikë ka ndikuar në rritjen e indikatorit të besueshmërisë, ndërsa në tetor të tre përbërësit kanë kontribuar në rritje.



Zbërthimi i indikatorit të besueshmërisë sipas madhësisë së ndërmarrjeve, tregon se ka diferenca të rëndësishme të këtij indikator ndërmjet ndërmarrjeve me madhësi të ndryshme (shiko Figurat 27-29).




Figura 27 tregon që indikatorin e besueshmërisë për NV është negativ për të tre periudhat e vrojtimit. Në maj 2002, indikatorin e besueshmërisë është zvogëluar me 1 pikë, që do të thotë se drejtuesit janë më pesimistë se në janar 2002. Në tetor 2002, drejtuesit e NV ishin me 7 pikë më pak të shqetësuar se në maj 2002.





Figura 28 paraqet indikatorin e besueshmërisë, dhe tregon që në maj 2002, për NMs klima e biznesit, si dhe për NV është përkeqësuar. Në tetor 2002, drejtuesit e NMs janë treguar më optimistë për biznesin e tyre (e paraqitur me shenjë pozitive të indikatorit të besueshmërisë me 4%).

Figura 29 tregon që në 2002 drejtuesit e NMs ishin më optimistë lidhur me biznesin e tyre. Nga krahasimi i rezultateve të Figurave 23 dhe 28 mund të thuhet që NMs kanë kontribuar për shumicën e besueshmërisë më të madhe për biznesin në sektorin industrial në Shqipëri.





Si përfundim, gjatë 2002, siç mund të pritet NV janë drejt një rritje negative të prodhimit, e cila vjen nga mënjanimi i tyre prej rritje së aktivitetit të NMs.

Konkluzione: Indikatorin e besueshmërisë së industrisë është i rëndësishëm për të kuptuar mjedisin e biznesit. Ky indikator vlerësohet nga tre faktorë: (1) parashikimi i biznesit, (2) vlerësimi i kërkesave për blerje dhe (3) vlerësimi i gjendjes aktuale të stokut. Kështu, përgjigjet e drejtuesve që janë optimistë ose pesimistë lidhen me perspektivën e biznesit të tyre.. NVM kanë një rritje të vazhduar të biznesit, dhe kjo lidhet me zvogëlimin e nivelit të stokut të produkteve të gatshme. NV kanë treguar që, në maj 2002, drejtuesit janë më pesimistë se në janar 2002. NV janë duke u eliminuar nga NMs. NMs treguan se mjedisi i biznesit ka qenë i keq në gjysmën e parë të 2002, por situata është përmirësuar në gjysmën e dytë të 2002. NMs ndihen të fuqishme, duke kontribuar pozitivisht në biznesin industrial. NVM-80 ndryshojnë nga TOTAL i ndërmarrjeve dhe nuk është i ngjashëm me NVM, të konsideruara në të dhënat statistikore dhe ato të vëzhgimeve të biznesit.



2.1.1. Kërkesat për eksport dhe parashikimet e eksportit

Të shikojmë disa indikatorë të tjerë, që janë gjeneruar nga rezultatet e vërtetimit të biznesit. Këta indikatorë na ndihmojnë për të pasur një tablo më të mirë të mbarëvajtjes së NVM-ve në sektorin industrial.



Vlerësimi i kërkesave për eksport, sipas madhësisë së ndërmarrjeve, tregon një situatë mjaft pesimiste sipas sipërmarrësve. Figura 30, tregon që gjatë 2002, drejtuesit e NMs u shprehën që kërkesat për eksport do të uleshin më shumë gjatë maj 2002, dhe më pak në tetor 2002. Balanca e përgjigjeve të NMD paraqet që kërkesat për eksport në tetor 2002 dukeshin sikur binin kundrejt trekatër muajve më parë, ndërsa po të shikohen parashikimet për eksporte (Figura 32), pritet që eksportet e NMD të rriten në 2003. Figura 31 paraqet vlerësimin për NVM-80. Duke krahasuar vlerësimet për klasat e madhësisë të paraqitura në vërtetime, Figura 30 dhe vlerësimi për NVM-80, ka pak ndryshime ndërmjet NVM dhe NVM-80, por tendencat janë të njëjta. Diferenca vjen nga pjesa e NMD që ka të punësuar nga 50-80 vetë.

Figura 32 paraqet që balanca, si përqindje e përgjigjeve pozitive dhe negative nga drejtuesit e ndërmarrjeve të mesme (si dhe të NMD), është pozitive për të gjithë vitin 2002, gjë që tregon që drejtuesit janë optimistë që për 2003 eksportet do të rriten. Figura 33 tregon vlerësimin për NVM-80.



Duke krahasuar vlerësimet sipas klasave të madhësisë të përdorura në vërtetimet, Figura 32, dhe vlerësimi për NVM-80, tregon që ekzistojë diferenca të vogla ndërmjet tyre, por kanë të njëjtën tendencë. Diferenca është rezultat i pjesës së NMD me 50-80 punonjës.

Konkluzione: Indikatori i kërkesave për eksport dhe parashikimet e eksportit kanë një rëndësi të veçantë kur ndodhemi para situatës së mungesës së të dhënave statistikore për eksportet. Indikatori paraqet tendencat për eksport. Drejtuesit e NVM janë pesimistë lidhur me eksportet gjatë vitit 2002. Situata duket më e mirë në tetor 2002, megjithëse drejtuesit prapë janë pesimistë. NMs dhe NMD presin një rritje gjatë 2003. Tendencat e NVM dhe NVM-80 janë të njëjta. Diferencat vijnë nga ndikimi i pjesës së NMD që punësojnë nga 50 deri 80 vetë. Diferenca e bën më evident nevojën e rishikimit të të dhënave në përputhje me klasat e madhësive të përkufizuara sipas ligjit të NVM.

2.1.2. Parashikimet e punësimit.

Figura 34 siguron informacion për një indikator tjetër të rëndësishëm, siç është ai i parashikimit të punësimit.





Figura 34 tregon që gjatë 2003 NMs dhe NMD do të sigurojnë më shumë vënde pune për tregun e punës. Nga ana tjetër, NV ka gjasa të ulin numrin e të punësuarve për 2003. Vetëm në tetor 2002, balanca e përgjigjeve në përqindje për ndërmarrjet e vogla është pozitive me 5 pikë. Megjithatë, rezultatet e përgjithshme të vërtetimit në tetor tregojnë që parashikimi i punësimit është më i ulët, krahasuar me rezultate të majit. Figura 35 tregon vlerësimin për NVM-80, dhe shihen ndryshime të vogla ndërmjet NVM dhe NVM-80, por tendenca është e njëjtë. Diferencat janë pasojë e pjesës së NMD me 50-80 vetë të punësuar.

Rezultatet e vërtetimeve të biznesit konfirmojnë informacionin statistikor për periudhën 1997-2000, i cili ka treguar që NMs kanë luajtur rol të rëndësishëm për rritjen e mundësive të tregut të punës për punësim. Por, këto mundësi janë të kufizuara për ndërmarrjet e vogla.

Konkluzione: Indikatori i parashikimit të punësimit, ka një korelacion pozitiv, me prodhimin. Parashikimi pozitiv për punësimin natyrisht që të çon për një rritje të pritshme të prodhimit. Vlerësimi i NMs dhe NMD tregon që punësimi në këto madhësi pritet për tu rritur gjatë 2003. NV pritet të zvoglojë numrin e të punësuarve gjatë 2003. Rezultatet e vërtetimeve të biznesit theksojnë konkluzionin statistikor për 1997-2000, që NMs kanë punësuar shumicën e personave. Tendencat e NVM dhe NVM-80 janë të njëjta. Ndryshimet vijnë nga ndikimi i pjesës së NMD me 50-80 vetë të punësuar. Diferencat e bëjnë më evidente nevojën e rishikimit të të dhënave statistikore që të jenë në përputhje me ligjin e NVM.



2.2. Kufizimet e prodhimit

Në 2002, të dhënat e vrojtimeve të biznesit për sektorin e industrisë treguan një variacion në kohë, jo vetëm në total por dhe për klasat e ndryshme të ndërmarrjeve. Këto zhvillime çojnë në konkluzionin që ndryshimi në kohë i mjedisit të biznesit, është i ndryshëm për klasa të ndryshme të ndërmarrjeve. Figurat 36 dhe 37, janë ndërtuar për të analizuar ndikimin e faktorëve kufizues, të cilët kanë ndikuar në aktivitetin prodhues sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

Kufizimet e prodhimit në sektorin e industrisë monitorohen nëpërmjet 15 faktorëve, të cilët mund të ndahen në tre lloj penguesish:

- Kufizuesit lidhur me kërkesën (1 dhe 2)
- Kufizuesit lidhur me furnizimin (3, 4, 5, 6, 7 dhe 8)
- Kufizuesit në mjedisin e biznesit (9, 10, 11, 12, 13, 14, dhe 15)

Figurat 36 dhe 37, tregojnë faktorët më të rëndësishëm që kufizojnë aktivitetin prodhues të NVM në Shqipëri.



Tregimi:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 1. Mungesë e kërkesës së brëndshme | 9. Mungesë e energjisë elektrike |
| 2. Mungesë e kërkesës nga jashtë | 10. Mungesë në infrastrukturë |
| 3. Konkurencë nga importi | 11. Probleme financiare |
| 4. Mungesë e fuqisë punëtore | 12. Vështirësi për të siguruar kredi |
| 5. Mungesë e fuqisë punëtore të kualifikuar | 13. Legjislacion ekonomik i paqartë |
| 6. Mungesë e paisjeve të përshtatshme | 14. Të papritura në mjedisin makro |
| 7. Mungesë në gjysëm produktet | 15. Proçedurat për liçensa |
| 8. Mungesë e lëndëve të para | 16. Të tjera |

Në janar 2002, furnizimi me energji elektrike dhe keq-interpretimi/keq-zbatimi i legjislacionit janë dy faktorët kryesorë kufizues. Në tetor 2002, mungesa e infrastrukturës, është konsideruar nga drejtuesit e NVM, si një pengesë e rëndësishme për biznesin e tyre.

Në janar 2002, mungesa e kërkesës nga tregu i brendshëm, ishte një faktor kryesor pengues për NVM, i cili në tetor 2002 ndikoi dhe tek NMd po me të njejtën masë si dhe NVM (renditur i katërti në tetor). Nga pikëpamja e furnizimit të materialeve, mund të cilësohet vetëm konkurenca nga importi, si një pengues për aktivitetin e biznesit të NVM. Rëndësia e këtij faktori është rritur më tej në tetor 2002, duke treguar që NVM në Shqipëri po ndihen relativisht të dobta dhe të papërgatitura për tu përballur me konkurrencën e huaj.

Duke ju kthyer analizës së përbërësve të indikatorit të besueshmërisë, për sektorin e industrisë – d.m.th. kërkesa, stoku dhe parashikimet e prodhimit (Figura 26) – mund të konkludohet që lloji i kufizuesve në mjedisin e biznesit (veçanërisht, mungesat në furnizimin me energji elektrike dhe mungesa në infrastrukturë) mund të kontribuojnë në zvoglimin e gjendjes së stokut, një shënjë e dobësimit të biznesit të ardhshëm për NVM, nëse nuk merren masat e përshtatshme në të ardhme për të frenuar ndikimin e këtyre faktorëve.

Konkluzione: Indikatorit të kufizimeve të prodhimit tregon ndryshimin në kohë të mjedist të biznesit:



- Mungesa e furnizimit me energji elektrike është kufizimi kryesor i biznesit (në janar dhe tetor 2002). Ka të njejtën peshë për të gjitha klasat e madhësisë së ndërmarrjeve.
- Legjislacioni i paqartë (keq-interpretimi/keq-zbatimi) është kufizuesi i dytë në renditje të kufizimeve në janar 2002, por në tetor ai renditet i pesti. NMs, në janar 2002 pengohen më pak se klasat e tjera të madhësisë, por më shumë në tetor.
- Mungesa e kërkesës nga tregu i brendshëm është një kufizues i rëndësishëm për NVM dhe NMs, në janar 2002. Në tetor ky kufizim renditet i katërti, por është më pak i rëndësishëm për NMs.
- Mungesa e infrastrukturës renditet si kufizues i tretë në janar 2002, por në tetor 2002 ai renditet i dyti. NMs e konsiderojnë këtë kufizues më të rëndësishëm se sa klasat e tjera të madhësisë.
- Problemet e likuiditeteve financiare konsiderohen si kufizim kryesor nga NVM në tetor 2002.

3. Zhvillimet e fundit në sektorin e ndërtimit


3.1. Indikatorit të besueshmërisë në ndërtim

Figura 38 tregon që në shtator 2002, në krahasim me prillin, mund të dallohet një pikë kthese në indikatorin e besueshmërisë në ndërtim, me qenë se ai kalon nga 2 pikë negative në 3 pikë pozitive.

Figura 40 tregon ndryshimet e përbërësve të indikatorit të besueshmërisë në ndërtim. Siç mund të vërehet, rritja e parashikimit për punësim ka qenë faktori, i cili ndikoi pozitivisht në indikatorin e besueshmërisë në ndërtim. Ndërsa, kërkesa duket se ka ardhur në ulje në prill dhe shtator, duke kontribuar negativisht në indikatorin e besueshmërisë.



Indikatori i besueshmërisë vlerësohet dhe për klasat e ndryshme të madhësisë së ndërmarrjeve (shiko Figurat 41-43). Figura 41 tregon që në prill 2002, indikatori i besueshmërisë në ndërtim për NV është negativ me 21 pikë, duke treguar që shumë drejtues të ndërmarrjeve të vogla janë pesimistë lidhur me biznesin e tyre. Në shtator 2002, dallojmë përsëri një ton pesimist të drejtuesve, me 16 pikë, i cili është më pak se tre muaj më parë, por ende në nivele të larta.



Në shtator, krahasuar me prill 2002, indikatori i besueshmërisë në ndërtim për NMs (Figura 42) tregon një ulje me 7 pikë, duke treguar që drejtuesit e NMs janë shumë më tepër të shqetësuar lidhur me biznesin e tyre, se sa tre muaj më parë.








Figura 43 tregon ndryshimet e indikatorit të besueshmërisë për NMD. Në prill 2002, indikatori i besueshmërisë është me 2 pikë pozitive, ndërkohë që ka patur rritje prej 20 pikësh në shtator 2002. Këto rezultate tregojnë që si dhe në sektorin e industrisë, rritja e besueshmërisë së drejtuesve në firmat e mëdha të ndërtimit ka kontribuar në një indeks besueshmërie të përgjithshëm për industrinë. Me tej, indikatori i besueshmërisë për NVM-t në sektorin e ndërtimit tregon që mbarëvajtja e tyre nuk është në të njëjtën linjë me ndërmarrjet e mëdha dhe përkeqësohet nga viti në vit.

Konkluzione: Indikatori i besueshmërisë në ndërtim vlerësohet sipas dy faktorëve: (1) kerkesave dhe (2) parashikimeve të punësimit. Shtatori 2002 është pika e kthesës së indikatorit. Në shtator faktori i parashikimit të punësimit ka treguar një rritje të konsiderueshme. Ndërkohë, faktori i kërkesave ka ardhur në ulje, por ndikimi i tij negativ është më pak se në prill. Drejtuesit e NV janë pesimistë në të dy vrojtimitet, por ndihen pak më mirë në shtator. Drejtuesit e NMs janë gjithashtu pesimistë, dhe ndihen më keq në shtator. Drejtuesit e NMD janë optimistë në të dy vrojtimitet dhe ndihen më mirë në shtator. Kjo klasë madhësie e ka kthyer në pozitiv indikatorin e besueshmërisë për sektorin.

3.2. Faktorët që kufizojnë aktivitetin e ndërtimit

Figurat 44 dhe 45, tregojnë faktorët kufizues të aktivitetit në ndërtim, në prill dhe shtator 2002, sipas madhësisë së ndërmarrjes. Kufizimet e biznesit (përjashto kufizimet në energji elektrike) për NVM në sektorin e ndërtimit ndryshojnë nga ato për sektorin e industrisë. Të dy figurat 43 dhe 44 tregojnë që kufizimet më kryesore, i dyti dhe i treti (në vërtetimin e shtatorit – shiko Figurën 41) për sektorin e ndërtimit janë zbatimi i pa ndershëm i ligjit fiskal dhe atij të prokurimit. Vështirësitë për të siguruar kredi dhe burime të tjera financiare janë gjithashtu të rëndësishme për sektorin e ndërtimit. Në ndryshim nga NMD, NVM përballen me më shumë probleme për sa i përket sigurimit të kërkesës nga tregu i brendshëm për punime ndërtimi. Mungesa e infrastrukturës ka më pak rëndësi, krahasuar me industrinë, dhe në shtator 2002 ky faktor është madje më pak i rëndësishëm krahasuar me rezultatet e prillit.



Legend:

1. Mungesë e kërkesës së brendshme
2. Konkurenë e pandershme nga zbatimi i ligjit të prokurimit
3. Konkurenca nga importi
4. Mungesë e fuqisë punëtore
5. Mungesë e fuqisë punëtore të kualifikuar
6. Mungesë e paisjeve të përshtatshme
7. Mungesë në gjysëm produktet
8. Mungesë e lëndëve të para
9. Mungesë e energjisë elektrike
10. Mungesë në infrastrukturë
11. Probleme financiare
12. Vështirësi për të siguruar kredi
13. Legjislacion ekonomik i paqartë
14. Të papritura në mjedisin makro
15. Proçedurat për liçensa
16. Të tjera
17. Vështirësi për leje ndërtimi
18. Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi



Konkluzione: Kufizimet në ndërtim, nxjerrin në pah ndryshimet në kohë të mjedisit të biznesit:

- Mungesa e kërkesës nga tregu i brendshëm është pengesa kryesore e biznesit (në prill dhe shtator 2002). Ka po të njëjtën peshë për të gjitha klasat e madhësisë së ndërmarrjeve. Në janar, por më shumë në tetor NMD ndihen më të kërcënuara.
- Legjislacioni i keq-interpretuar/keq-zbatuar është kufizimi i dytë. Në prill, NMs janë më të kërcënuara, ndërsa në shtator NMD ndihen më të forta.
- Mungesa e infrastrukturës konsiderohet si kufizim i tretë për NMD në prill.
- Konkurenca e pandershme konsiderohet kufizimi i tretë për NV dhe NMD, në tetor.
- Vështirësitë për të marrë kredi dhe për të siguruar burime të tjera financiare janë kufizimi i katërt (në prill dhe tetor). NMD ndihen më të kërcënuarat.

4. Investimet

4.1. Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve

Figurat 46 dhe 47 tregojnë tendencën e investimeve kapitale në sektorin e industrisë, e nxjerrë nga rezultatet e vrojtimit në maj dhe tetor 2002. Të dy figurat tregojnë që lidhur me tendencën e investimeve, NVM ndryshojnë nga NMD. Në maj 2002, rezultatet e vrojtimit tregojnë që NV kanë investuar më shumë për zgjerimin e fushës së prodhimit (shiko Figurën 46). Nga krahasimi, NMs janë përgjigjur se kanë investuar më shumë në rritjen e kapaciteteve prodhuese.



Legend

1. Zëvendësimi të makinerive dhe paisjeve të vjetra
2. Zgjerimi i kapacitetit prodhues
3. Zgjerimi i llojshmërisë së produkteve
4. Mekanizimi ose automatizimi i teknologjisë ekzistuese të prodhimit



Në tetor 2002 shumica e NVM kanë investuar për zëvendësimin e paisjeve të vjetra dhe për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese (kryesisht në NMs). Në këtë fazë zhvillimi, NVM janë më pak

të interesuara për të investuar për futjen e teknikave të reja të prodhimit, kursimit të energjisë, kontrollit të ndotjes, etj¹⁰.

Konkluzione: Indikatori i investimeve kapitale tregon stabilitetin e biznesit. Nuk investon njeri nëse biznesi mezi mbijeton ose po shkatërohet. Investimet në të gjitha ndërmarrjet i japin përparësi zëvendësimit të paisjeve të vjetra. Politika e investimit ndryshon për zgjerimin e gamës së prodhimit (përparësi në maj, më pak rëndësi në tetor). NV kanë investuar më shumë për mekanizimin dhe zgjerimin e gamës së prodhimit (në vrojtimin e majit). Vrojtimi i dytë në tetor, ka treguar që janë kryer më pak investime për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Vrojtimi i tetorit, tregoi që janë kryer më shumë investime, me përparësi zëvendësimin e kapaciteteve të vjetra prodhuese. NMD, sipas vrojtimi të tetorit, i kanë zvogluar investimet në përgjithësi dhe veçanërisht në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese.

4.2. Faktorët që kufizojnë investimet në të ardhmen

Figurat 48 dhe 49 tregojnë faktorët kryesorë që kufizojnë planifikimin e investimeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve në maj dhe tetor 2002. Siç mund të shihet nga figurat, grupi i faktorëve që ndikojnë në kufizimin e investimeve është i ndryshëm ndërmjet NVM dhe NMD. Në maj 2002, vetëm faktori që lidhet me vështirësitë e marrjes së kredive ka pak a shumë të njejtën rëndësi për të gjitha klasat e madhësive të ndërmarrjeve. Gjatë kësaj periudhe faktori kryesor, i cili kufizon NVM për të investuar në të ardhmen, është fitimi i pamjaftueshëm. Ky faktor është gjithashtu faktor kryesor në tetor 2002, duke treguar që fitimi është burimi kryesor i investimeve në NVM dhe së dyti, gjatë periudhës së 2002, përfitimi i NVM ka gjasa të jetë zvogluar.



Legend:

1. Mungesë e kërkesës së brëndshme
2. Kosto shumë e lartë e paisjeve kapitale
3. Vështirësi në sigurimin e kredive
4. Fitim i pamjaftueshëm
7. Të tjera

¹⁰ Sipas rëndësisë, këto lloj investimesh nuk janë treguar në Figurat 46 dhe 47.

Faktorë të tjerë të rëndësishëm që pengojnë drejtuesit e NVM për të investuar janë kosto e kapitalit dhe kërkesa e pamjaftueshme. Në grupin “të tjera” përmblihen faktorë si instabiliteti politik dhe kufizimet e furnizimit me energji elektrike. Këta faktorë nuk kanë ndonjë efekt në vendim-marrjen e NVM për investime. Ndërsa në tetor 2002 drejtuesit e NMD i konsiderojnë këta faktorë të një rëndësie të dorës dytë si pengues të investimeve për të ardhmen.

Konkluzione: Kufizimi i planifikimit të investimeve është i rëndësishëm për të kuptuar perspektivën e biznesit, duke patur si pikë-pamje pengesat për investim. Në përgjithësi për të gjitha ndërmarrjet, biznesi ndihet më shumë i kufizuar në tetor se sa në maj. NV konsiderojnë që kufizimi kryesor për të investuar është fitimi i pamjaftueshëm. NMs konsiderojnë si kufizues fitimin e pamjaftueshëm dhe koston e lartë të kapitalit. Në vërtetimin e tetorit NMD konsiderojnë mungesën e fitimit si pengesën kryesore për investime.

PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME TË PROJEKTIT

Analiza e zhvillimit të NVM, për periudhën 1997-2000¹¹ (bazuar në të dhënat statistikore), dhe për 2002 (bazuar në vërtetimet e biznesit), tregojnë një numër karakteristikash që kanë ndikuar për klasën më të rëndësishme të ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dhe veçanërisht në rritimin e rritjes së saj. Në një formë sintetike përfundimet më kryesore, të cilat ndikojnë në problemet e politikave, janë:

- NVM në Shqipëri përbëjnë shumicën e repertorit të ndërmarrjeve. Mesatarisht 99% e ndërmarrjeve punësojnë më pak se 50 punonjës.
- Mbarëvajtja e NVM ka ardhur duke u përkeqësuar, veçanërisht pas vitit 2000. Vetëm NMs tregojnë se kanë pasur një ecuri më të mirë se ndërmarrjet e klasave të tjera të madhësisë. NMs mund të ofrojnë në të ardhme më shumë vende pune për tregun e punës në Shqipëri, sepse janë tipi më dinamik i ndërmarrjeve dhe ato kanë planifikuar për të investuar më shumë në të ardhmen, krahasuar me strukturën tjetër të ndërmarrjeve (të voglat dhe të mëdhatë). Prandaj, në të ardhmen duhen hartuar politika të veçanta që ti mbështesin këto zhvillime.
- Drejtuesit e NVM mendojnë se janë të penguar nga një numër faktorësh, të cilët lidhen kryesisht me veprimin e mjedisit të biznesit si: energjia, infrastruktura, po ashtu dhe keq-hartimi /keq-zbatimi i legjislacionit.
- Qeveria duhet të përmirësojë strategjinë e privatizimit për sektorin e shërbimeve (veçanërisht transportin dhe shërbimet e tjera). Kjo sepse ndikimi i procesit të privatizimit pas 1998, në punësimin nga NVM, është shumë i rëndësishëm.
- NVM janë duke investuar më shumë për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe për zëvendësimin e makinerive të vjetra dhe më pak për teknologji të reja, modernizim dhe automatizim. Prandaj duhet hartuar një legjislacion fiskal për të mbështetur NVM që të investojnë për teknologji të reja dhe modernizim.

Kufizimet dhe veprimet në të ardhme

Është e rëndësishme të theksohet që ky raport nuk përmban ndonjë informacion të vlefshëm lidhur me zhvillimin e NVM, siç është kontributi për eksport, mbarëvajtja e NVM në aktivitete të rëndësishme siç janë shërbimet. Këto kufizime lidhen kryesisht me disponimin e të dhënave, afatin kohor dhe burimet që autorët kanë patur në dispozicion për këtë projekt. Megjithatë, raportet në të ardhmen mbi zhvillimet e NVM, duke u përqëndruar tek ndikimi i tyre në rritjen ekonomike, do të përmirësohen rrënjësisht në se ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Politik-bërësit do të informohen më mirë, në se raporte vjetorë mbi zhvillimin e NVM, do të jenë të plotësuar me rezultate të indikatorëve kuadër, të cilët do të jenë të disponueshëm çdo gjashtëmuor. Për të arritur këtë objektiv është e rëndësishme që:

¹¹ Të dhënat për 2001 nuk janë të disponueshme

- INSTAT duhet të përshpejtojë procesin e zbatimit të Sistemit të Llogarive Kombëtare, bazuar në praktika ndërkombëtare të njohura.
 - INSTAT duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për rishikimin e të dhënave sipas përkufizimit të Ligjit nr.8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”.
 - Të dhënat e vrojtimit të biznesit të jenë të disponueshme çdo tre muaj.
 - Të vazhdojë puna për kryerjen e vrojtimit periodik të biznesit në kuadrin e programit të harmonizimit të BE-së, për vrojtimet e biznesit.
- Organizimi i një vrojtimi vjetor, i hartuar veçanërisht për NVM do të ishte i nevojshëm. Ky vrojtim do të kapë problemet, që lidhen me sipërmarrjen dhe drejtimin, pengesat administrative dhe taksimin, si dhe probleme të tjera që lidhen me veçantitë e mjedisit të biznesit për NVM dhe që mungojnë në këtë Raport.

Aneksi 1

Studimet e mëparshme mbi zhvillimin e NVM-ve

Në vitet e fundit janë ndërmarrë disa programe kërkimore për të kuptuar natyrën dhe nevojat e aktivitetit të NVM në Shqipëri. Sipas, vëzhgimeve tona një punë e tillë nuk ka qenë sistematike dhe me një këndshikim tjetër nga ai i analizave të atyre ndërmarrjeve. Punimet më kryesore të një natyre të tillë janë:

1. Ekonomia informale: Evazioni fiskal dhe puna e zezë. *Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike*; Tiranë, Mars 1999
2. Vrojtimit i organizatave të përfshira në rregulloret dhe nxitjen e NVM në Shqipëri; *Qendra për Nxitjen e Zhvillimeve të Burimeve Njerëzore*; Tiranë, Nëntor 1999.

Qëllimi kryesor i vrojtimit ishte identifikimi i pengesave kryesore që frenojnë krijimin dhe rritjen e NVM, dhe që përfshijnë:

- Rregulloret
 - Proçedurat
 - Taksimin
 - Legjislacionin e përgjithshëm
3. Zhvillimi i sektorit privat, Përafrimi strategjik; *GTZ – DEG SME*, Tiranë, Nëntor 1999. Raporti është fokusuar në çështjet që vijojnë:
 - Identifikimi i problemeve dhe të mundësive të NVM.
 - Grumbullimi i informacionit të përshtatshëm për gjenerimin dhe vlerësimin e veprimeve të ardhshme.
 - Propozime dhe rekomandimeve për NVM, drejtuar qeverisë, që të krijojë një klimë të favorshme dhe të drejtuar.
 - Një udhëzues afat-shkurter dhe afat-gjatë për veprime të detajuara dhe një mbështetje efektive për sektorin privat.
 4. Vrojtimi i komunitetit shqiptar të biznesit. *AATDA (Shoqata Shqiptaro – Amerikane e Zhvillimit të Tregtise)*; Tiranë 2002. Ky vrojtimit ka patur këto objektiva:
 - Identifikimi i kërkesave të përgjithshme dhe specifike dhe të potencialeve për zhvillime të harmonizuara në Shqipëri.
 - Rekomandime për politikat qeveritare dhe programe që lidhen me zhvillimin e NVM.
 - Zbatimi i fushatës për të ndikuar mbi qeverinë dhe sektorin privat lidhur me reformat që kanë të bëjnë me biznesin.
 5. Përcaktorët e rritjes. *IDRA (Instituti për Zhvillim, Kërkim dhe Alternativa)*; Tiranë, 2002. Ky raport përmban:
 - Situata e përgjithshme politike, ekonomike dhe sociale;
 - Rritja e burimeve njerëzore;
 - Prodhimi dhe rritja;
 - Tregjet financiarë;
 - Ndikimi i shëndetit dhe mjedisit.

Karakteristikat e përgjithshme të kërkimeve të mëparshme janë:

- Ato paraqesin mjedisin e biznesit në një situatë statike.
- Prezantim i një vëzhgimi historik.
- Konkluzionet janë rezultat i të dhënave të grumbulluara nga vrojtme me kampion jo-prezentativ.

Ky studim tenton që të plotësojë boshllëkun e studimeve të mëparshme duke siguruar një instrument metodologjik për vlerësimin e një kompleti indikatorësh kuadër që bëjnë të mundur vlerësimin e mbarëvajtjes së NVM gjatë 5 viteve të fundit. Si studim i pari i këtij lloji në Shqipëri ai mund të përdoret për të ndjekur zhvillimin e NVM dhe ndikimin e politikave të ndryshme qeveritare.

Aneksi 2

Indikatorët e NVM sipas sektorëve (%)

		Të gjithë Sektorët				Industri				Ndërtim				
		1997	1998	1999	2000	1997	1998	1999	2000	1997	1998	1999	2000	
NUMRI I NDERMARRJEVE	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
		Të Vogla	97.9	98.1	98.2	98.2	90.3	90.9	91.7	90.4	89.4	89.0	89.0	
		Mikro	91.1	92.0	92.6	92.1	75.5	76.7	77.3	76.0	33.9	37.3	43.3	42.6
		Të Mesme	1.0	0.8	0.8	1.0	2.9	3.3	3.1	4.1	5.9	7.6	4.4	8.1
		Të Mëdha	1.2	1.1	1.0	0.9	6.8	5.9	5.2	5.5	4.7	3.4	5.7	2.9
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	9.6	17.1	-0.6	:	10.7	1.2	-4.0	:	20.6	21.7	-13.1
		Të Vogla	:	9.8	17.3	-0.6	:	11.4	2.2	-5.4	:	19.9	22.9	-13.9
		Mikro	:	10.6	17.8	-1.1	:	12.4	2.0	-5.7	:	32.9	41.2	-14.5
		Të Mesme	:	-3.4	9.7	21.2	:	23.5	-2.4	26.0	:	55.8	-29.6	59.6
		Të Mëdha	:	3.1	3.3	-11.3	:	-4.2	-11.4	2.5	:	-12.2	105.6	-56.8
NUMRI I TE PUNESUARVE	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
		Të Vogla	41.3	40.3	46.1	46.1	13.6	15.3	17.4	17.2	45.6	47.5	52.3	51.8
		Mikro	30.1	30.7	34.9	34.1	7.7	8.7	10.1	9.6	8.3	9.6	12.4	10.5
		Të Mesme	5.8	5.2	5.4	7.5	4.3	5.4	6.4	8.5	12.7	21.7	10.1	24.2
		Të Mëdha	52.9	54.5	48.5	46.4	82.1	79.3	76.2	74.3	41.7	30.8	37.5	24.0
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	10.1	0.2	-2.7	:	-3.4	-12.7	0.0	:	-8.7	14.9	-10.1
		Të Vogla	:	7.6	14.6	-2.7	:	8.2	-0.5	-1.5	:	-4.9	26.5	-10.9
		Mikro	:	12.4	14.0	-4.9	:	9.5	1.4	-4.7	:	5.0	49.0	-23.6
		Të Mesme	:	-2.6	5.5	33.9	:	22.8	2.6	33.6	:	56.1	-46.2	114.6
		Të Mëdha	:	13.5	-10.9	-6.8	:	-6.7	-16.0	-2.5	:	-32.6	40.0	-42.5
SHIFRA E AFARIZMIT	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
		Të Vogla	59.4	57.9	62.6	58.0	17.9	21.8	29.9	27.1	51.5	57.3	63.1	47.0
		Mikro	40.2	41.3	43.7	37.5	10.4	10.9	15.6	13.5	9.7	10.2	14.5	5.9
		Të Mesme	7.8	7.1	10.1	13.2	6.2	6.6	8.3	9.3	15.7	25.4	20.1	34.7
		Të Mëdha	32.8	35.0	27.3	28.8	75.9	71.6	61.8	63.7	32.8	17.3	16.8	18.3
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	49.8	15.6	13.9	:	8.6	4.4	4.4	:	53.0	46.7	25.7
		Të Vogla	:	46.0	25.0	5.4	:	32.2	43.3	-5.5	:	70.4	61.6	-6.4
		Mikro	:	54.0	22.3	-2.5	:	13.9	49.3	-9.8	:	61.4	107.8	-49.1
		Të Mesme	:	36.9	63.9	49.0	:	15.6	30.2	16.6	:	147.3	16.0	117.4
		Të Mëdha	:	59.8	-9.9	20.2	:	2.4	-9.9	7.6	:	-19.5	42.6	36.6
VLERA E SHTUAR	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
		Të Vogla	41.8	45.2	43.8	41.4	10.3	17.9	19.1	16.6	39.6	48.6	47.2	46.1
		Mikro	28.8	35.0	34.2	29.5	5.9	9.5	10.5	8.8	7.0	10.8	12.1	10.1
		Të Mesme	6.1	9.0	10.2	11.2	4.2	9.3	8.5	6.0	13.6	28.9	28.0	26.8
		Të Mëdha	52.1	45.8	46.0	47.4	85.5	72.8	72.4	77.4	46.8	22.6	24.7	27.1
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	23.7	42.7	5.5	:	-14.3	16.5	17.5	:	10.0	42.0	32.7
		Të Vogla	:	33.9	38.3	-0.4	:	49.3	24.3	2.3	:	35.1	38.1	29.5
		Mikro	:	50.5	39.5	-9.0	:	38.6	28.0	-1.7	:	69.3	58.2	10.9
		Të Mesme	:	82.5	61.3	16.6	:	87.2	7.1	-17.9	:	132.8	37.8	27.1
		Të Mëdha	:	8.7	43.4	8.7	:	-27.0	15.8	25.7	:	-47.0	55.6	45.2
INVESTIMENT	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	
		Të Vogla	36.7	30.2	37.0	38.9	18.9	22.8	13.3	36.8	22.4	51.6	48.2	81.3
		Mikro	20.7	21.2	14.3	21.8	10.1	15.8	4.0	27.5	7.9	10.1	12.1	21.8
		Të Mesme	6.7	6.3	8.2	11.6	6.6	9.4	5.1	12.8	5.3	21.1	40.5	17.5
		Të Mëdha	56.6	63.5	54.8	49.5	74.4	67.8	81.5	50.4	72.2	27.3	11.3	1.2
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	67.6	66.2	-25.1	:	26.4	-11.1	56.3	:	-41.3	39.9	61.1
		Të Vogla	:	37.9	103.6	-21.3	:	52.1	-47.9	330.7	:	35.0	30.9	171.6
		Mikro	:	71.8	12.1	14.0	:	97.4	-77.3	962.4	:	-24.1	67.0	189.1
		Të Mesme	:	58.8	114.4	6.4	:	79.5	-51.4	290.1	:	131.6	168.3	-30.5
		Të Mëdha	:	88.0	43.5	-32.3	:	15.1	6.9	-3.4	:	-77.8	-42.2	-82.5
PRODHIMTARIA	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	12.4	42.4	8.5	:	-21.1	11.6	12.5	:	20.6	23.5	47.6
		Të Vogla	:	24.4	20.7	2.4	:	22.2	-13.2	8.2	:	42.0	9.2	45.4
		Mikro	:	33.9	22.3	-4.4	:	21.6	-14.3	9.0	:	61.3	6.2	45.2
		Të Mesme	:	87.4	52.9	-12.9	:	57.6	-17.8	-29.6	:	49.1	156.0	-40.8
		Të Mëdha	:	-4.2	61.0	16.7	:	-28.8	28.5	16.8	:	-21.2	11.2	152.7
PJESA E KOSTOS SE PUNES NDAJ VLERES SE SHTUAR	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	-0.1	-24.5	8.8	:	24.4	-18.2	-6.5	:	4.6	-20.4	-21.2
		Të Vogla	:	-21.6	1.0	10.2	:	-34.4	-19.3	10.2	:	-17.7	-5.2	-28.1
		Mikro	:	-33.9	17.6	10.0	:	-20.4	-25.3	18.5	:	-35.4	5.8	-31.8
		Të Mesme	:	-26.5	-29.2	1.6	:	-18.6	3.4	53.0	:	-7.5	-40.4	10.5
		Të Mëdha	:	15.4	-32.3	3.7	:	43.4	-19.6	-13.2	:	63.3	-23.9	-32.5
PERFITIMI	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	0.1	16.5	-3.8	:	-23.7	28.7	6.5	:	-3.9	18.9	13.1
		Të Vogla	:	6.9	-0.2	-2.4	:	35.5	9.6	-3.7	:	14.3	3.0	15.1
		Mikro	:	7.5	-2.4	-1.6	:	10.5	9.4	-4.7	:	26.6	18.8	-6.8
		Të Mesme	:	15.1	10.6	-0.4	:	10.7	-1.4	-23.5	:	6.5	30.8	-3.7
		Të Mëdha	:	-13.8	38.9	-2.2	:	-41.6	46.1	17.1	:	-53.3	70.4	42.7

		Tregti				Transport				Shërbime të Tjera				
		1997	1998	1999	2000	1997	1998	1999	2000	1997	1998	1999	2000	
NUMRI I NDERMARRJEVE	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
		Të Vogla	99,8	99,7	99,7	99,7			99,3	99,3	98,1		98,8	98,9
		Mikro	96,3	97,4	97,6	97,0	99,5	97,1	97,8	97,3	92,2	94,3	92,9	91,8
		Të Mesme		0,2	0,3	0,2			0,2	0,2	1,3		0,6	0,7
		Të Mëdha		0,1	0,05	0,1		0,7	0,5	0,4	0,5	0,5	0,5	0,5
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	13,3	18,3	-4,8	:	17,6	44,6	14,1	:	-4,8	7,1	4,6
		Të Vogla	:	13,2	18,3	-4,8	:			14,2	:			4,6
		Mikro	:	14,5	18,6	-5,4	:	14,8	45,6	13,5	:	-2,5	5,4	3,3
		Të Mesme	:		48,6	-26,9	:			40,0	:			9,8
		Të Mëdha	:		-47,1	22,2	:		4,0	-3,8	:	-14,7	20,7	-8,6
NUMRI I TE PUNESUARVE	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
		Të Vogla	90,9	90,0	92,2	93,7			32,0	36,7	70,2		70,2	69,1
		Mikro	77,0	80,8	82,6	81,4	72,7	22,0	28,8	32,6	56,8	58,7	54,4	52,9
		Të Mesme		3,1	4,3	3,6			1,4	1,9	11,2		5,7	6,3
		Të Mëdha		6,9	3,5	2,7		74,4	66,7	61,4	18,6	27,0	24,1	24,6
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	18,2	10,7	-7,2	:	308,6	7,2	-2,9	:	-11,1	17,0	1,0
		Të Vogla	:	17,0	13,4	-5,7	:			11,5	:			-0,5
		Mikro	:	24,0	13,3	-8,6	:	23,4	40,6	9,8	:	-8,1	8,4	-1,6
		Të Mesme	:		51,4	-21,3	:			32,9	:			11,1
		Të Mëdha	:		-43,3	-29,7	:		-4,0	-10,6	:	28,9	4,6	3,1
SHIFRA E AFARIZMIT	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
		Të Vogla	86,6	84,7	83,9	77,5			39,1	33,5	85,9		77,6	81,4
		Mikro	60,5	65,2	62,1	53,3	82,4	17,1	36,4	28,2	68,1	72,3	66,5	64,3
		Të Mesme		6,7	9,2	14,8			11,7	3,3	4,1		7,1	4,2
		Të Mëdha		8,6	6,9	7,7		74,0	49,2	63,2	9,9	16,3	15,3	14,4
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	49,2	15,0	19,8	:	690,2	21,0	10,0	:	33,9	20,3	0,8
		Të Vogla	:	45,9	13,9	10,6	:			-5,7	:			5,8
		Mikro	:	60,7	9,6	2,7	:	64,2	157,2	-14,8	:	42,2	10,7	-2,4
		Të Mesme	:		58,5	92,7	:			-68,6	:			-40,2
		Të Mëdha	:		-8,2	33,9	:		-19,5	41,3	:	120,8	12,7	-5,0
VLERA E SHTUAR	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
		Të Vogla	79,8	83,9	84,2	74,0			26,9	21,7	79,2		67,5	71,6
		Mikro	55,9	72,8	70,8	58,1	80,6	21,9	25,5	18,6	62,7	55,6	55,4	57,4
		Të Mesme		11,1	13,4	20,3			5,6	2,4	6,6		9,5	10,6
		Të Mëdha		5,0	2,4	5,6		70,5	67,4	75,9	14,2	34,8	23,0	17,7
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	26,1	25,8	18,3	:	526,5	136,5	-22,6	:	32,5	12,5	10,4
		Të Vogla	:	32,6	26,2	4,1	:			-37,8	:			17,2
		Mikro	:	64,3	22,3	-2,8	:	70,2	175,3	-43,3	:	17,5	12,0	14,3
		Të Mesme	:		51,8	79,4	:			-66,7	:			23,6
		Të Mëdha	:		-39,1	176,8	:		126,4	-12,9	:	224,2	-25,5	-15,0
INVESTIMENT	Përqindja ndaj Totalit	Totali	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	
		Të Vogla	88,9	83,9	80,6	76,2			7,2	8,1	59,8		79,5	54,0
		Mikro	52,7	61,9	20,8	30,3	51,7	1,7	4,7	4,5	39,1	80,7	71,8	27,6
		Të Mesme		7,4	15,7	20,8			0,2	1,8	3,8		9,6	13,8
		Të Mëdha		8,7	3,7	3,0		96,6	92,7	90,1	36,4	1,2	10,9	32,3
	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	-11,6	375,2	-68,9	:	6811,5	84,3	-48,2	:	82,6	38,1	-39,1
		Të Vogla	:	-16,5	356,5	-70,6	:			-41,7	:			-58,7
		Mikro	:	3,9	59,8	-54,7	:	122,2	420,0	-50,0	:	276,4	22,9	-76,6
		Të Mesme	:		904,9	-58,8	:			517,6	:			-12,4
		Të Mëdha	:		102,4	-74,7	:		76,7	-49,6	:	-94,0	1152,6	80,3
PRODHIMTARIA	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	6,7	13,7	27,6	:	53,3	120,6	-20,3	:	49,0	-3,8	9,2
		Të Vogla	:	13,3	11,3	10,4	:			-44,2	:			17,7
		Mikro	:	32,5	8,0	6,3	:	37,9	95,8	-48,4	:	27,9	3,4	16,2
		Të Mesme	:		0,2	128,0	:			-74,9	:			11,2
		Të Mëdha	:		7,3	294,0	:		135,8	-2,6	:	151,6	-28,8	-17,6
PJESA E KOSTOS SE PUNES NDAJ VLERES SE SHTUAR	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	-13,6	-3,5	-27,0	:	35,5	-46,4	43,4	:	-25,4	17,8	9,6
		Të Vogla	:	-25,4	3,2	-15,6	:			-25,2	:			-0,7
		Mikro	:	-38,9	-2,1	-20,1	:	-9,8	84,6	-25,4	:	-35,3	39,7	-5,9
		Të Mesme	:		-17,4	-47,9	:			151,1	:			-9,5
		Të Mëdha	:		48,1	-73,9	:		-56,0	51,1	:	-63,4	65,7	47,4
PERFITIMI	Ndryshimet Vjetore	Totali	:	2,6	0,6	4,2	:	-10,8	21,3	-8,8	:	15,3	-7,0	-4,8
		Të Vogla	:	4,6	-0,4	2,1	:			6,5	:			0,2
		Mikro	:	6,9	0,2	2,0	:	1,3	-10,3	6,4	:	7,3	-5,0	1,1
		Të Mesme	:		1,6	3,6	:			-19,5	:			4,0
		Të Mëdha	:		-30,2	98,6	:		27,5	-8,7	:	278,2	-27,9	-46,2

Aneksi 3

Fillimi i veprimtarisë së NVM-ve sipas territorit (%)

		1997	1998	1999	2000
Përqindja ndaj totalit	Berat	2,6	4,0	7,2	5,4
	Dibër	1,6	1,5	0,9	1,8
	Durrës	9,7	8,1	8,4	4,8
	Elbasan	2,1	2,6	1,6	2,0
	Fier	5,5	11,7	7,2	9,0
	Gjirokastrë	2,7	4,6	2,1	2,6
	Korçë	3,6	12,3	7,5	8,7
	Kukës	1,6	1,1	0,4	0,3
	Lezhë	3,8	2,9	3,8	5,3
	Shkodër	3,4	1,7	3,0	4,0
	Tiranë	60,9	43,8	51,8	50,0
	Vlorë	2,5	5,6	6,0	5,9
	Total	100,0	100,0	100,0	100,0
	Ndryshimet Vjetore	Berat	:	197,0	133,2
Dibër		:	80,5	-21,6	134,5
Durrës		:	58,3	34,3	-34,3
Elbasan		:	144,4	-20,5	40,0
Fier		:	306,3	-21,2	44,7
Gjirokastrë		:	223,9	-41,3	43,7
Korçë		:	553,2	-21,7	33,3
Kukës		:	31,0	-49,1	-10,7
Lezhë		:	45,0	66,2	61,8
Shkodër		:	-2,2	120,7	55,2
Tiranë		:	36,8	52,3	11,1
Vlorë		:	325,8	38,1	13,1
Total		:	90,5	28,7	15,0